



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në Gjykatën Kushtetuese

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“AUDITIM FINANCIAR”

NË

GJYKATËN KUSHTETUESE

Mars 2024

Nr. Përmbatja	FAQE
I. Përmbledhje ekzekutive	
1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të auditimit.....	3
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3-5
3.Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	6-7
II. Hyrja	
1.Objekti dhe Qëllimi i auditimit.....	8
2.Identifikimi i çështjes.....	8
3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4.Përgjegjësitë e audituesve.....	8-9
5.Kriteret e vlerësimit.....	9
6.Standardet e auditimit.....	9
7.Metodat e auditimit.....	9
8.Dokumentet e auditimit.....	10
III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.Information i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	10
2.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit:	
2.1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.....	10-23
- Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, realizimi i planit buxhetor, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.....	10-23
2.2.Auditimi i llogarive vjetore.....	23-34
Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.....	23-34
-Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.....	23-34
2.3.Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	34
Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.....	34-36
2.4. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....	36-48
IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET	48-52
V.ANEKSE	52-63

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Raporti i auditimit të ushtruar në Gjykatën Kushtetuese (*këtu e më poshtë GJK*) prezanton çështjet kryesore të rezultuara në veprimtarinë e institucionit si: zbatimi i kritereve në planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, auditimin e llogarive vjetore, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, rakordimi me pasqyrat e tjera financiare, zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës si dhe probleme të dala gjatë auditimit (*auditimi i dy procedurave të prokurimit me kërkesë të GJK nr.1036/3, datë 22.12.2023(prot.KLSH)*).

Disa nga gjetjet kryesore të evidentuara, si dhe rekomandimet përkatëse në mënyrë të përmbledhur jepen më poshtë:

1.2 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. NË RPA	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare, viti 2022:</p> <p>-Llog.nr.327 “Objekte Inventari”, rezulton se shuma prej 832,850 lekë është e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe nuk ka të dhëna për secilin aktiv si pjesë përbërëse të kësaj llogarie. Në analitikun e kësaj llogarie, nuk ka të dhëna ku të specifikoheshin kërkesat që duhet të përmbajë një aktiv mbi datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes etj.,</p> <p>-Llog. nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet me vlerë kontabël 5,079,082 lekë si dhe në vitin 2021 me vlerë kontabël 1,432,020 lekë. Në debi të saj janë kontabilizuar fatura për mallra dhe shërbime të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.</p> <p>Nga ana e Drejtorisë Ekonomike detyrimet e prapambetura të cilat janë fatura për mallra dhe shërbime në fund të periudhës ushtrimore për vitin 2022 në shumën prej 5,079,028 lekë, janë keqklasifikuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, llogari e cila duhet të përfaqësojë debitorë (të trashëguar ndër vite). Shuma prej 5,079,028 lekë duhej të regjistrohej në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale</p>	<p>Fq. 35</p> <p>Fq.37</p>	<p>E mesme</p> <p>E mesme</p>	<p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese, për ngritjen një grup pune me specialistë të fushës, për të kryer inventarizimin dhe saktësimin e vlerës prej 832,850 lekë në llogarinë nr.327 “Objekte Inventari”.</p> <p>-Të merren masa nga Drejtoria Ekonomike, të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar ndër vite në lidhje me këtë llogari, për nxjerrjen e të dhënave për aktivet afatshkurtra si pjesë përbërëse, duke i saktësuar dhe analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet si dhe në inventarin fizik.</p> <p>Afati zbatimit: Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023</p> <p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Drejtoria Ekonomike, për të kryer sistemimet e detyrimeve në kontabilitet në fund të periudhave ushtrimore duke i riklasifikuar ato në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila është një llogari që në Pasqyrat Financiare të Sektorit Publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit)</p>

	<p>merren nga buxheti i shtetit) me kundërparti llogarinë nr.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.</p> <p>Veprimet e sipërme janë jo në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, pika 26 dhe pika 30.</p>			<p>me kundërparti llogarinë nr.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.</p> <p>Afati zbatimit: Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023</p>
2	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese”, për hartimin e dokumenteve të tenderit/ kriteret e veçanta, rezultoi se kriteri “<i>kamera termike</i>”, pika 2.3.7(<i>mjetet,pajisjet</i>) nuk është analizuar mbi domosdoshmërinë e disponimit nga operatori si dhe nuk është në përputhje me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve të parashikuar në preventiv, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “<i>Për prokurimin publik</i>” i ndryshuar neni 35, pika 2 dhe 3 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 39, pika 4 dhe pika 6, germa “d”.</p> <p>- Nga auditimi mbi vlerësimin e ofertave për procedurën “Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese” rezultoi se:</p> <p>-shtojca 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, nuk është plotësuar nga të gjithë operatorët e BOE, për pjesën 1. A. jo në përputhje me DT, Shtojca 8, pjesa I, pika A; Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 82, pika 2.</p> <p>- Nga KVO nuk është kërkuar sqarim për vertetimin nr.7022/1, datë 04.10.2022 lëshuar nga OSHEE për OE “A.a” ku rezulton që shoqëria në sistemin e faturimit të mos ketë kontratë me OSHEE, dhe nëse oferta ndodhet në kushtet e “devijimit” të vogël, duke mos e përshkruar këtë veprim në procesverbalin e shqyrtimit të ofertave, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i” si dhe neni 2, pika 2.</p> <p>-licenca e projektimit për administratorin e shoqërisë “A.a” është për kategorinë 2b “<i>projektim objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara</i>” dhe jo kategorinë 2.a të kërkuar, jo në përputhje me DT, pika 2.3.2.c,</p> <p>-kontrata datë 10.02.2021 lidhur mes zhvilluesit të pronës B.M. dhe shoqërisë “M.K” me object ndërtimin e strukturës ku do të zhvillohet veprimtari agriturizmi blegtoral, nuk plotëson kushtet për punë të ngjashme në zbatim, pasi objekti i tenderimit ka të bëjë me rikonstruksion e sallës së gjyqeve dhe jo strukturë agriturizmi të cilat nga pikëpamja teknike</p>	Fq.49-52	E mesme	<p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Njësia përgjegjëse për prokurimin, që në të ardhmen, përgatitja e dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta, të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor dhe të jenë të analizuar në detaj, me qëllim që të jenë në proporcion me objektin e kontratës dhe të rrisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në prokurime.</p> <p>Afati zbatimit: Rast pas rasti</p>
		Fq.49-52	E mesme	<p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese, që në të ardhmen shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me kriteret e kërkuara në çdo detaj të tyre si dhe çdo sqarim i marrë nga operatorët dhe procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në tërësinë e tij, të reflektohet në procesverbalin e mbajtur nga KVO.</p> <p>Afati zbatimit: Rast pas rasti</p>

	<p>nuk janë të ngjashme, jo në përputhje me DT, kriteri 2.3.1.a.</p> <p>-Nga BOE nuk është paraqitur kontratë bashkëpunimi për zbatimin e punimeve nga OE MK, i cili sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.10.2022 merr përsipër të realizojë 94.3% të punimeve të zbatimit, jo në përputhje me DT, pika 2.3.2.b</p>			
3	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”, në planifikimin e nevojave dhe kërkesës për prokurim rezultoi se kërkesa Nr.411, datë 26.04.2023, e Drejtorisë Gjyqësore dhe Dokumentacionit drejtuar NA dhe NZ, nuk paraqet qartë se nga kush është bërë evidentimi i gjendjes aktuale të sistemeve IT, por shprehet në përgjithësi nevoja për kryerjen e këtij planifikimi, nuk është bashkangjitur kërkesës analiza/raporti teknik i vlerësimit gjendjes aktuale të sistemeve IT, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1, pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1.</p> <p>-Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”, mbi vlerësimin e ofertave rezultoi se:</p> <p>-nga auditimi në SPE dhe dosje fizike të OE “F” SHPK, certifikata e paraqitur në emër të B. L. nga “C” rezultoi të jetë aktive, ndërkohë që KVO e ka skualifikuar operatorin pasi, në SPE dokumenti rezultoi pa linkun përkatës të verifikimit dhe pa kodin e sigurisë.</p> <p>KVO ka kërkuar nga OE me e-mail të sjellë linkun përkatës si dhe kopje të certifikatës, të cilat pas dërgimit nga ana e operatorit të linkut, KVO nuk arriti të gjejë certifikatën në këtë link si dhe OE nuk solli kopje të saj. Në procesverbalin e mbajtur nga KVO mbi shqyrtimin e certifikatës së sipërcituar, nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të qartë mënyra e kërimit dhe verifikimit në linkun përkatës si dhe nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i gjeneruar pas verifikimit të linkut, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i”.</p>	Fq.52-56	E mesme	<p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese për plotësimin e dosjes së prokurimit “<i>Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT</i>”, duke bërë pjesë përbërëse të dosjes analizën e plotë financiare dhe teknike mbi planifikimin e nevojave dhe kërkesës për prokurim.</p> <p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese që në të ardhmen analiza teknike dhe financiare për planifikimin e nevojave për prokurim të jetë pjesë përbërëse e e dosjeve të prokurimit.</p> <p>Afati zbatimit: Menjëherë, rast pas rasti</p>
	<p>-nga auditimi në SPE dhe dosje fizike të OE “F” SHPK, certifikata e paraqitur në emër të B. L. nga “C” rezultoi të jetë aktive, ndërkohë që KVO e ka skualifikuar operatorin pasi, në SPE dokumenti rezultoi pa linkun përkatës të verifikimit dhe pa kodin e sigurisë.</p> <p>KVO ka kërkuar nga OE me e-mail të sjellë linkun përkatës si dhe kopje të certifikatës, të cilat pas dërgimit nga ana e operatorit të linkut, KVO nuk arriti të gjejë certifikatën në këtë link si dhe OE nuk solli kopje të saj. Në procesverbalin e mbajtur nga KVO mbi shqyrtimin e certifikatës së sipërcituar, nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të qartë mënyra e kërimit dhe verifikimit në linkun përkatës si dhe nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i gjeneruar pas verifikimit të linkut, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i”.</p>	Fq.52-56	E ulët	<p>-Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese, që në të ardhmen procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, të reflektohet në tërësi dhe në çdo detaj të tij në procesverbalin e mbajtur prej saj, me qëllim që procesi i vlerësimit të jetë transparent.</p> <p>Afati zbatimit: Rast pas rasti</p>

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)¹:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Gjykatës Kushtetuese (këtu e më poshtë GJK), për periudhën ushtrimore 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të Gjykatës Kushtetuese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Gjykatës Kushtetuese në datën 31.12.2022 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar.

Audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pakualifikuar, ku nuk rezultojnë devijimet materiale. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar** mbi pasqyrat financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin financiar në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, të miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e marra gjatë auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit **të pakualifikuar**. Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë pragu i materialitetit për vitin 2022 (në masën 0.7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar në vlerën 2,937 mijë lekë për shpenzimet, për tu konsideruar), pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të Gjykatës Kushtetuese, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes së paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII, pika 7.4.1: “Opinionin i pa kualifikuar/pamodifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.”.

e aplikuar në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme që të shprehë një opinion për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) në bazë të auditimit të kryer, nëse tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, gjithashtu aplikojnë edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë, përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si edhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1036/2 prot., datë 14.12.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.12.2023 deri në datë 29.01.2024, në subjektin Gjykata Kushtetuese (*këtu e më poshtë GJK*) u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga 01.01.2021 deri në 30.12.2023 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.M. H, (Përgjegjës Grupi)
- 2.A. H, Auditues
- 3.S. Z, Auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: zbatimi i kriterëve në planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, auditimin e llogarive vjetore, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare, zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës dhe probleme të dala gjatë auditimit (*auditimi i dy procedurave të prokurimit me kërkesë të GJK nr.1036/3, datë 22.12.2023(prot.KLSH)*).

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt konstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren (GJK) me datë 29.01.2024 me Kryetarin e GJK, me përfaqësues të strukturave drejtuese, si dhe grupit të auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 2/2) parashikuar në “*Rregulloren e Procedurave të Auditimit*”, miratuar me Vendimin nr.107 datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar. Pas dërgimit të observacioneve mbi Projektraporin e auditimit në ambientet e KLSH është zhvilluar takimi i mirëkuptimit datë 12.04.2024, me përfaqësues

nga GJK, sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 12) parashikuar në “*Rregulloren e Procedurave të Auditimit*”, miratuar me Vendimin Nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH.Në përfundim të takimit çështjet që u morën në konsideratë u reflektuan në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

1. Objekti i auditimit dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit financiar me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021-2023 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të Gjykatës Kushtetuese, referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar.

Auditimi financiar ka si qëllim vlerësimin nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së GJK-se.

2. Identifikimi i çështjes.

Projektraporti mbi auditimin financiar të veprimtarisë së GJK-se Tiranë, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor,
- përputhshmëria/rregullëshmëria në mbajtjen e kontabilitetit,
- përputhshmëria me kriteret ligjore në auditimin e llogarive vjetore,
- përputhshmëria me kriteret ligjore në zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/GJK-së dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;
- Nëse shpenzimet janë planifikuar mbi bazën e nevojave në nivel institucioni nëse janë realizuar në përputhje me planin e miratuar nga ministri i Financave;
- Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore lidhur me planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor, mbajtjen e kontabilitetit;
- Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;
- Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

5.Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.);
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6.Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

- ISSAI 200 (Parime themelore të auditimit financiar);
- ISSAI 100 (Parime themelore të auditimit të sektorit publik), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;
- Praktikat më të mira të fushës.

7.Metodat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, Gjykata Kushtetuese funksion në zbatim të Ligjit Nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8.Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e GJK-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykitit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti.

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/GJK-së dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

-Nëse shpenzimet janë planifikuar mbi bazën e nevojave në nivel institucioni nëse janë realizuar në përputhje me planin e miratuar nga ministri i Financave;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore lidhur me planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor, mbajtjen e kontabilitetit;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare;

-Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Hartimi, zbatimi i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit Nr. 1036/2, datë 14.12.2023 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Vendimi Nr.2, datë 27.01.2021 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për miratimin e drejtimeve kryesore të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2021;

- Vendimi Nr.2, datë 09.21.2022 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për miratimin e drejtimeve kryesore të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2022;
- Vendimi Nr.2, datë 24.01.2023 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për miratimin e drejtimeve kryesore të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023;
- PBA 2021-2023, projektbuxheti viti 2021;
- PBA 2022-2024, projektbuxheti viti 2022;
- PBA 2023-2025, projektbuxheti viti 2023;
- Raportet e realizimit të buxhetit për vitet 2021,2022 dhe 2023.

Auditimi u bazua në:

- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar
- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar;
- Ligjet e buxhetit për vitet 2021, 2022 dhe 2023;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave:
 - “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”*; *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024”*; *“Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025”*; *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”*; *“Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 - 2026”*; *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026”*;
- Udhëzimet e Ministrit të Financave:
 - “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*; *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”*; *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*; *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”* të MFE;
 - “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”*,
- Udhëzimi Nr.14, datë 30.05.2023 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”* të MFE;
- Çdo akt ligjor e nënligjor në funksion të zbatimit të buxhetit të shtetit për vitet 2021-2023.

Viti 2021, PBA 2021-2023, projektbuxheti viti 2021.

Gjykata Kushtetuese (GJK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm bazuar në Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*.

Me Urdhrin nr.9, datë 09.04.2019 të titullarit të GJK është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe me Urdhërin Nr.8, datë 2019 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP), të cilët kanë kryer funksionet e tyre deri në vitin 2022. Me shkresën nr.251/1, date 31.8.2020, GJK ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, projektbuxhetin afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e projektbuxhetit të vitit 2021, (faza II-të). Kërkesat buxhetore janë detajuar në mbështetje të misionit të Gjykatës Kushtetuese për garantimin e respektimit të Kushtetutës, në realizimin e qëllimit të politikës së programit, tavanëve të miratuara në VKM nr.577/2020 *“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”* si dhe në Vendimin Nr.2, datë 27.01.2021 të Mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesat buxhetore pasqyrohen në programin *“Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”* (03320) dhe detajohen në 7 produkte, pasqyruar në Tabelën1 (*seksioni Anekse*).

Me shkresën Nr.386, datë 29.12.2020 është dërguar në MFE detajimi i buxhetit të vitit 2021, pas miratimit të Ligjit Nr.137/20202, datë 16.11.2020 *“Për buxhetin e vitit 2021”*, për programin e vetëm buxhetor 03320 *“Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese”*.

Me Ligjin nr. 137/2020, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2021, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Gjykata Kushtetuese” në vlerën 155,000,000 lekë.

Ndryshimet buxhetore në vitin 2021.

Në grupin buxhetor “Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese”, janë bërë disa ndryshime gjatë vitit. Në zbatim të Ligjit Nr.137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, buxheti i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2021, nga 155,000,000 lekë i miratuar në fillim të vitit buxhetor, pakësohet në 150,200,000 lekë (-4,800,000 lekë). Ndryshimi vjen si rezultat i efekteve që rrjedhin nga Akti Normativ Nr. 26, dt. 22.06.2021, sipas të cilit Gjykatës Kushtetuese i zbriten 5,000,000 lekë nga fondi i pagave.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet në buxhetin e vitit 2021 jepen në tabelë:

	<i>Në lekë</i>
Shtesa (shpenzimet për transferta familjare & individuale (Ilog. 606)	200,000
Pakësime (Akti Normativ nr. 26, dt. 22.06.2021)	-5,000,000
TOTALI	-4,800,000

Burimi: GJK

Për vitin 2021, buxheti i Gjykatës Kushtetuese nga 150,200,000 lekë me ndryshimet buxhetore u realizua në shumën 131,501,974 lekë ose 88 %.

Realizimi i treguesve kryesorë të buxhetit për vitin 2021, paraqitet në Tabelën 2 (*seksioni Anekse*).

Buxheti për vitin 2021, është realizuar me një diferencë prej -18,698,026 lekë, e cila përbëhet nga:

-Diferenca -14,230,280 lekë rrjedh nga mos përdorimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, si pasojë e mos plotësimit të numrit të punonjësve në organikë (-6 punonjës).

-Diferenca -4,305,826 lekë, rrjedh nga mos përdorimi i fondeve për shpenzimet (Ilog.602-606).

-Diferenca -161,920 lekë rrjedh si pasojë e mbetjes së fondeve (*për shkak të ofertave të paraqitura nën kufirin e ulët monetar*) për investime.

Treguesit kryesorë të buxhetit, realizuar sipas zërave përbërës për vitin 2021:

-Numri i punonjësve në total, realizuar 90%, diferenca në fund të vitit -6 punonjës. Nga 62 punonjës të miratuar në strukturë në buxhetin e vitit 2021, numri i punonjësve rezulton 56. Në zbatim të VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore”, Gjykatës Kushtetuese shtohen 2 punonjës arkive me kontratë pune të përkohshme 1 vjeçare, bazuar në Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 20, pika 3.

-Shpenzimet për pagat e punonjësve (Ilog.600) dhe për sigurime shoqërore e shëndetësore (Ilog.601) në total janë realizuar në masën 88%, nga 120,000,000 lekë buxhet i miratuar janë realizuar 105,769,720 lekë, me një diferencë prej 14,230,280 lekë.

Sipas zërave përbërës detajohet:

-Zëri “Shpenzime për pagat e punonjësve (600)”, nga 108,000,000 lekë është realizuar me 95,388,166 lekë ose 88% e fondit vjetor me një diferencë prej -12,611,834 lekë.

-Zëri “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)”, nga 12,000,000 mijë lekë, është realizuar me 10,381,554 lekë, ose 87%, e fondit vjetor me një diferencë prej -1,618,446 lekë.

-Zëri “Shpenzime operative (602)” nga 25,500,000 lekë sipas buxhetit realizuar me 21,319,542 lekë ose 84% e fondit vjetor, me një diferencë prej -4,180,548 lekë.

Realizimi i shpenzimeve operative sipas nënzërave përbërës:

-Grupi i shpenzimeve “**Materiale zyre dhe të përgjithshme (602.0)**”, nga 2,890,000 lekë, sipas nevojave të rishikuara, realizuar 2,327,117 lekë me një diferencë prej -562,883 lekë ose 81%, ku shpenzimet përfshijnë abonimet në shtypin e brendshëm dhe të huaj etj, si dhe shpenzimet për blerjen e tonerave për printera. Pjesa tjetër përbëhet nga shpenzimet për blerjen

e materialeve për ndriçim, pastrim, blerjen e dosjeve gjyqësore, letër për fotokopje, bojra për fotokopje e printera, etj, duke plotësuar nevojat e rishikuara dhe siguruar gjëndjen e nevojshme në magazinë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 3 (seksioni Anekse):

-Grupi i shpenzimeve “**Materiale dhe shërbime speciale (602.1)**”, nga 2,228,000 lekë u realizua me 1,312,458 lekë ose 60 %, me një diferencë prej -915,542 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 4 (seksioni Anekse).

-Grupi “**Shërbime nga të tretë (602.2)**”, nga 5,568,000 lekë, realizuar 4,850,709 lekë ose 87 % e tyre, me një diferencë prej -717,291 lekë. Në këtë grup futen shpenzimet për energji elektrike, telefoni fikse e mobile, hostimi i faqes së internetit, shërbimet postare, si dhe kostoja e trajnimeve për seminarët e kualifikimit. Në mënyrë të detajuar shpenzimet jepen në Tabelën 5 (seksioni Anekse).

-Grupi “**Shpenzime transporti (602.3)**”, nga 6,555,000 lekë, realizuar 6,503,565 lekë ose 99%, me një diferencë prej -51,435 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 6 (seksioni Anekse).

Në vitin 2021 në zbatim të kontratës së lidhur me vlerë 4,799,985 lekë me TVSH, janë blerë gjithsej 29,645 litra karburante nga të cilat 21,445 litra naftë me çmim 134.7 lekë/litër dhe 8,200 litra benzinë me çmim 135.53 lekë/litër, duke siguruar rezervë në sasi edhe për vitin 2022. Shpenzimet për karburante janë llogaritur mbi bazën e limiteve mujore të vitit 2021, si dhe të gjëndjes së karburanteve në magazinë në fillim të vitit 2021 e cila ishte 14,581 litra benzinë dhe 8,006 litra naftë.

Kuotat mujore të konsumit të karburanteve sipas limiteve të miratuara në vitin 2021 (*Urdhri nr. 13, datë 08.03.2021*), jepen në Tabelën 7 (seksioni Anekse).

Për vitin 2021, janë konsumuar në total 19,860 litra naftë dhe 10,030 litra benzinë. Në datën 31.12.2021, sasia e karburantit të mbetur rezulton 9,591 litra naftë dhe 12,751 litra benzinë.

-Grupi “**Shpenzime udhëtimi (llog.602.4)**”, nga 4,000,000 lekë parashikuar për 2021, realizuar 520,000 lekë, shkak pandemia dhe kufizimet në lëvizje, pjesa tjetër është rialokuar në llogari të tjera të shpenzimeve operative ku kishte mungesë fondesh. Sipas detajimi grupi u plotësua me 30,096 lekë ose rreth 6 %, me një diferencë prej -489,904 lekë. Shpenzimet në vlerën e 30,096 lekëve përfaqësojnë shpenzimet vetëm për dieta ditore. Gjatë vitit 2021, janë realizuar vetëm 2 udhëtime/veprimtari jashtë vendit (*Kosovë, Itali*) për shkak të situatës Covid-19.

-Grupi “**Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (602.5)**”, nga 4,262,000 lekë u realizua me 3,274,328 lekë ose 77% e tyre, me një diferencë prej -987,672 lekë.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 8 (seksioni Anekse) si dhe Shpenzimet për “Mirëmbajtje dhe servis makinash” detajohen në Tabelën 9 (seksioni Anekse).

Nga GJK, janë marrë automjete me leasing (*duke ju referuar praktikave të ngjashme ndjekur nga institucione të tjera si Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 automjete*) pasi janë të amortizuara dhe në mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit për blerjen e automjeteve të reja. Shpenzimi i marrjes me qera për të dyja automjetet është rreth 155,000 lekë/muaj (1,860,000 lekë/vit), duke mbajtur parasysh fondin në dispozicion, për momentin një shpenzim i tillë ose i përafërt nuk mund të realizohet, pasi do të krijonte vështirësi në mirëmbajtjen vjetore të automjeteve të tjera në pronësi të gjykatës.

-Zëri “**Shpenzime për qiramarrje (llog.602.6)**”, të cilat nga 2,178,000 lekë sipas buxhetit të rishikuar u realizuan me 2,178,000 lekë ose 100%. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen pagesa e kryer për Bashkinë Tiranë për parkimin e automjeteve të institucionit (11 vende parkimi).

-Zëri “**Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale (602.7)**”, nuk ka veprime të kryera ose pagesa të kësaj natyre.

-Zëri “**Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua (602.8)**” nuk ka veprime të kryera ose pagesa të kësaj natyre.

-Grupi “**Shpenzime të tjera operative (602.9)**”, nga 1,299,000 lekë u realizua me 843,179 lekë ose rreth 65%, me një diferencë prej -455,821 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 10 (seksioni Anekse)

-Zëri “**Shpenzime për transferta korrente të huaja (Ilog.605)**” nga 500,000 lekë të planifikuara, realizuar 442,200 lekë, ose 88%. Shuma përbëhet nga dy pagesa, pagesa e parë 2,000 euro (253,200 lekë) e kryer në Shkurt 2021, përfaqëson kontributin financiar për vitet 2020-2021 të Gjykatës Kushtetuese, si anëtare e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese, ndërsa pagesa e dytë 1,500 euro (189,000 lekë) e kryer në Prill 2021, përfaqëson tarifën për pjesëmarrjen në takimin on line të Rrethit të Kryetarëve dhe në Kongresin e XVIII të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane.

-Zëri “**Shpenzime për transferta korrente të brendshme (Ilog.606)**” është realizuar 66% ose 132,522 lekë nga 200,000 lekë të miratuar, që përfaqësojnë pagesa për shpërblime për dy punonjës me rastin e daljes në pension pleqërie, si dhe pagesa për rimbursim shpenzimesh telefonike.

-Zëri “**Investime, ose shpenzime kapitale (Ilog.230-231)**”, u realizua në masën 96%, nga 4,000,000 lekë investime të miratuara në buxhet u realizuan 3,838,080 lekë. Shpenzimet për investime jepen të detajuara në Tabelën 11 (seksioni Anekse)

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale të buxhetit të vitit 2021, u bazuan në aktet pasqyruar në seksionin Ankese.

Nga buxheti i shtetit për vitin 2021, u akorduan 4,000,000 lekë, të cilat fillimisht ishin ndarë në 1,500,000 lekë për paisje kompjuterike, 1,540,000 lekë për paisje zyre dhe 960,000 lekë për tituj/libra për bibliotekën. Në Mbledhjen e Gjyqtarëve për përcaktimin e drejtimeve kryesore të shpenzimit për vitin 2021 (miratuar me vendimin Nr.2, datë 27.01.2021), është kërkuar që vlera prej 1,200,000 lekë nga fondi për paisje zyre të rialokohej për rinovimin e rrjetit informatik. Në Mars 2021, fondi u rialokuan nga MFE. Pas kryerjes së prokurimeve të parashikuara dhe realizimit të investimeve (paisje kompjuterike, rrjet informatik, tituj për bibliotekën), mbetën pa u shfrytëzuar (si pasojë e ofertave anomalisht të ulta), afërsisht 900,000 lekë. Kjo vlerë, me kërkesën e GJK, u rialokua nga MFE në zërin “Paisje Zyre” në Nëntor 2021, e cila së bashku me fondin e mbetur në zërin paisje zyre, në total rreth 1,200,000 lekë, është përdorur për veshjen e dyerve të zyrave të katit të dytë me tapiceri, me qëllim izolimin akustik, blerjen e një kondicioneri të ri për sallën e mbledhjeve dhe disa arredime zyrash.

Nga prokurimet e zhvilluara janë realizuar gjithsej 16,377,686 lekë pa TVSH nga 18,593,582 lekë pa TVSH të parashikuara, ose 88%, duke përjashtuar kontratat për furnizimin me energji elektrike, ujë, telefoni fikse e mobile dhe shërbimin postar. Kontratat me prokurim me vlerë të vogël dhe kontratat me vlerë deri në 100,000 lekë, me vlerë të përlllogaritur prej 8,913,082 lekë pa TVSH, janë realizuar në vlerë 8,132,096 lekë pa TVSH.

Programi “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”, përbëhet nga produktet, performanca e të cilave në terma sasiorë dhe monetarë paraqitet, si më poshtë:

I.Produktet me shpenzime korrente përbëhen nga: **Produkti 1 “Vendime të marra”**.

Produkti për vitin 2021, ishte parashikuar në 200 vendime të marra i cili është tejkaluar gjatë vitit 2021, në 201 vendime të marra në total. Nga këto:76 vendime të marra për kërkesa të regjistruara përpara vitit 2021 kur Gjykatës Kushtetuese i mungonte kuorumi i nevojshëm dhe në 125 vendime, të marra për kërkesa të regjistruara gjatë vitit 2021. Parashikimi për realizimin e këtij produkti ishte rreth 90%, por realizimi është 100% Shpenzimet korrente për këtë produkt janë realizuar në vlerën 127,663,894 lekë nga 146,200,000 lekë sipas programit të rishikuar ose 87 %.

II. "Produktet me shpenzime administrative kapitale", Produkti "Paisje per zyra".

Konkretisht u realizua veshja me tapiceri e dyerve të zyrave të gjyqtarëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të kabinetit (për izolim akustik), si dhe u rinovua pjesërisht mobilimi në dy zyra. Fondi i planifikuar (rialokim) për kompletimin e zyrave dhe sigurimin e kushteve normale të punës, sipas programit të rishikuar ishte 1,195,000 lekë i cili u realizua në vlerën 1,142,800 lekë shprehur në përqindje, në masën 96%.

Produkti "Bibliotekë e pasuruar".

Pas konsultimit me gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë është hartuar lista me 28 tituj të rinj librash të cilët pas kryerjes së procedurave të prokurimit janë blerë dhe janë vendosur në bibliotekën e gjykatës. Fondi i rialokuar për këtë produkt ishte 605,000 lekë, i cili u realizua në vlerën 503,000 lekë ose 82%.

Produkti "Sisteme të informatizuar" (paisje informatike dhe rrjeti informatik).

Fondi për blerjen e paisjeve informatike ishte planifikuar 1,500,000 lekë, por pas rialokimeve u finalizua në 1,120,000 lekë, i cili u realizua në vlerën 1,114,680 lekë. Numri i paisjeve për këtë produkt është realizuar tërësisht dhe në përputhje me kërkesat tona përsa i përket sasive. Paisjet e blera janë 5 laptop, 5 PC, 10 printera bardh e zi, 1 printer me ngjyra, si dhe 8 ups. Gjatë vitit 2021, është investuar për herë të parë në rinovimin tërësor të rrjetit informatik dhe kompjuterik të saj, pasi rrjeti i mëparshëm ishte pjesërisht i ndërthurur me rrjetin e Kuvendit, gjë që sillte probleme në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tij. Gjithashtu rrjeti i vjetër ishte pothuajse totalisht i amortizuar dhe jo në përputhje me standartet teknike të kohës. Fondi për rinovimin e rrjetit informatik ishte planifikuar 1,200,000 lekë por që pas rialokimeve u finalizua në 1,080,000 lekë dhe u realizua në vlerën 1,077,600 lekë.

-Viti 2022, PBA 2022-2024, projektbuxheti viti 2022;

Gjykata Kushtetuese (GJK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm bazuar në Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Gjykata Kushtetuese (GJK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Me Urdhrin nr.45, datë 20.04.2022 të titullarit të GJK është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe me Urdhërin Nr.44, datë 20.04.2022 është krijuar Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) për programin 03320 "Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese".

Gjykata Kushtetuese ka përcjellë në MFE projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 (faza I) me shkresën nr.186, datë 30.04.2021, dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e projektbuxhetit të vitit 2022 (faza II-të) me shkresën nr.343 datë, 31.08.2021. Kërkesat në projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024 (faza II-të), janë hartuar në programin bazë (03320) "Veprimtaria gjyqësore kushtetuese", që përbëhet nga 6 produkte sipas tavanëve të miratuara dhe 7 produkte sipas kërkesave për politikën e reja.

Me shkresën nr. 504, datë, 31.12.2021, është dërguar në MFE, detajimi i buxhetit të vitit 2022, pas miratimit të Ligjit Nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022".

Me Ligjin Nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor "Gjykata Kushtetuese" në programin e vetëm (03320) "Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese", me vlerë totale prej 171,760,000 lekë dhe 62 punonjës në organikë.

Ndryshimet buxhetore në vitin 2022.

Buxheti për Gjykatën Kushtetuese për vitin 2022 nga 171,760,000 lekë të miratuar u reduktua në 166,762,331 lekë, me një ndryshim neto prej -4,997,669 lekë si pasojë e daljes së Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, sipas të cilit Gjykatës Kushtetuese ju zbritën 5,851,000 lekë. Në mënyrë të detajuar ndryshimet e buxhetit për vitin 2022 paraqiten në tabelë:

Në lekë

Shtesa (Fondi i veçantë-Ilogaria 606)	+853,331
---------------------------------------	----------

<i>Shpenzime për ndihmë të menjëhershme, shpërblime, etj. (Ilog. 606)</i>	+853,331
Pakësime (Akti Normativ nr. 3, dt. 12.03.2022)	-5,851,000
<i>Fondi i pagave (Ilogaria 600)</i>	-2,825,000
<i>Fondi i sigurimeve shoqërore (Ilogaria 601)</i>	-300,000
<i>Shpenzime operative (Ilogaria 602)</i>	-2,726,000
Efekti neto në buxhet (shitesa-pakësime)	-4,997,669

Burimi: GJK

Buxheti i GJK për vitin 2022, nga 166,762,331 lekë pas ndryshimeve është realizuar në shumën 165,951,403 lekë ose 99.5 %.

Realizimi i treguesve kryesorë të buxhetit, pasqyrohet në Tabelën 12 (seksioni Anekse)

Nga Buxheti i vitit 2022, vlera prej 810,928 lekë ka mbetur pa u shfrytëzuar e cila përbëhet nga:

- Mbetjet në fondin e sigurimeve shoqërore në vlerën 270,805 lekë;
- Mbetjet në fondet për shpenzimet (602-606) në vlerën 215,926 lekë.
- Mbetja e fondeve (për shkak të ofertave të paraqitura) në vlerën 324,197 lekë.

Realizimi i buxhetit sipas zërave përbërës të tij për vitin 2022 rezulton:

-Numri i punonjësve, në total numri i punonjësve u realizua 89%, me një diferencë në fund të vitit prej -7 punonjës. Nga 62 punonjës në organikë të miratuar në buxhetin e vitit 2022, numri i punonjësve faktik është 55.

Me VKM Nr. 35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”, GJK i janë shtuar 2 specialiste arkive me kontratë pune të përkohshme njëvjeçare, në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 20, pika 3.

-Shpenzimet për “**pagat**” e punonjësve (Ilog.600) dhe për sigurime shoqërore e shëndetësore (Ilog.601) në total, janë realizuar nga 121,875,000 lekë në 121,604,195 lekë, me një diferencë prej 270,805 lekë ose 99.8%. Sipas zërave përbërës detajohet:

Zëri “Shpenzime për pagat e punonjësve (Ilog.600)”, nga 110,175,000 lekë, realizuar me 110,174,570 lekë, që përbën 100%, të fondit vjetor me një diferencë prej -430 lekë.

Zëri “Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Ilog.601)”, nga 11,700,000 lekë, realizuar 11,429,625 lekë, ose 99.7%, të fondit vjetor me një diferencë prej -270,805 lekë.

Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në masën 99.8% është ndikuar edhe nga kompensimi i diferencave të pagës që u bë gjatë vitit 2022, për gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, pas rillogaritjes së pagave të tyre për periudhën 01.01.2019-31.03.2021, sipas legjisllacionit në fuqi dhe rekomandimeve të KLSH-së, të shprehura në raportin e saj të auditimit dërguar me shkresën Nr. 1029/8, datë 15.02.2021, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 5, datë 05.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Zëri “Shpenzime operative (Ilog.602)” nga 23,934,000 lekë planifikuar, realizuar me 23,930,437 lekë me një diferencë prej vetëm -3,563 lekë, realizuar 100%.

Realizimi i shpenzimeve operative sipas nën zërave përbërës detajohet si më poshtë:

-Grupi i shpenzimeve “**Materiale zyre dhe të përgjithshme (Ilog.602.0)**”, nga 2,683,441 lekë, u realizua 2,683,424 lekë ose 100%, me një diferencë prej vetëm -17 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 13 (Seksioni Anekse).

-Grupi i shpenzimeve “**Materiale dhe shërbime speciale (Ilog.602.1)**”, nga 1,744,904 lekë u realizua 1,743,926 lekë ose 100 %, diferenca -978 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 14 (Seksioni Anekse).

-Grupi “**Shërbime nga të tretë (Ilog.602.2)**”, nga 3,950,180 lekë u realizua 3,947,647 lekë ose 100%, diferenca -2,534 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 15(seksioni Anekse).

-Grupi “**Shpenzime transporti (602.3)**”, nga 4,924,811 lekë, u realizua me 4,924,811 lekë ose 100%.Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 16 (seksioni Anekse).

Në datën 01.01.2022 sasi të e karburantit në magazinë kanë qenë përkatësisht 9,591 litra naftë dhe 12,751 litra benzinë. Për të siguruar nevojat për karburante gjatë vitit 2022 u realizua kontrata nr. 54/1 datë 28.06.2022 me vlerë 3,435,000 lekë, në bazë të së cilës u blenë 14,686 litra naftë nga të cilat 8,000 litra me cmim 243 lekë/litër (*fatura nr. 6482/2022, dt. 04.07.2022*) dhe 6,686 litra me cmim 222.99 lekë/litër (*fatura nr. 9963/2022, dt. 04.10.2022*).

Kuotat mujore të konsumit të karburanteve sipas limiteve të miratuar në vitin 2022 (*urdhri i titullarit nr. 56 prot., datë 25.01.2022 dhe urdhri nr. 221/3 prot., datë 06.05.2022 janë pasyruar në Tabelën 17 (seksioni Anekse)*).

Gjatë vitit 2022 janë konsumuar në total 22,023 litra naftë dhe 9,985 litra benzinë. Në datën 31.12.2022, sasia e karburantit të mbetur është përkatësisht 2,254 litra naftë dhe 2,766 litra benzinë.

Me kartën e karburantit N6, gjatë vitit 2022, janë shpërndarë 533 litra naftë për:

-Udhëtimin e dy këshilltarëve ligjorë në Kosovë me automjetin personal në muajin Maj (sasia 93 litra).

-Furnizimin me karburant të tre automjeteve të ILD për 30-vjetorin - sasia 120 litra.

-Furnizimin me karburant të gjyqtarit për pjesën e mbetur të muajin Dhjetor 2022 dhe kuota e muajit Janar 2023-sasia 320 litra.

Me kartën e karburantit N7, Gjatë vitit 2022, është shpërndarë 60 litra naftë për udhëtimin në Kosovë të dy këshilltarëve ligjorë me automjetin personal në muajin Dhjetor.

-Grupi “**Shpenzime udhëtimi (Ilog.602.4)**”, nga 4,077,908 lekë plani 2022, u realizua 4,077,874 lekë ose 100 %, diferencë prej -34 lekë. *Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 18 (seksioni Anekse)*.

Grupi “**Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (Ilog.602.5)**”, në vlerën 2,129,916 lekë u realizua 100%. *Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 19(seksioni Anekse)*.

“Shpenzimet për “Mirëmbajtje dhe servis makinash” pasqyrohen në Tabelën 20 (*seksioni Anekse*)

Zëri “**Shpenzime për qiramarrje (Ilog.602.6)**”, nga 2,178,000 lekë plani realizuar 2,178,000 lekë ose 100%. Në këtë grup shpenzimesh përfshihen pagesa e kryer për Bashkinë Tiranë për parkimin e automjeteve të institucionit (11 vende parkimi).

Zëri “**Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale (Ilog.602.7)**”, nuk ka veprime të kryera ose pagesa të kësaj natyre.

Zëri “**Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua (Ilog.602.8)**” nuk ka veprime të kryera ose pagesa të kësaj natyre.

Grupi “**Shpenzime të tjera operative (Ilog.602.9)**”, në vlerën 2,244,840 lekë realizuar 100%. *Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 21 (Seksioni Anekse)*.

-Zëri “**Shpenzime për transferta korrente të huaja (605)**” nga 700,000 lekë të planifikuara, realizuar 693,975 lekë, ose 99%. Shuma përbëhet nga tre pagesa:

Pagesa 2,290 euro (*285,334 lekë*) e kryer në Janar 2022, për kuotizacionin vjetor 2021, si anëtare e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone-ACCF;

Pagesa 1,000 euro (*127,200 lekë*) e kryer në Mars 2022 për kuotizacionin 2022, si pjesëmarrës në Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese;

Pagesa 2,290 euro (*281,441 lekë*) e kryer në Maj 2022, për kuotizacionin 2022, si anëtare e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone-ACCF.

-Zëri “**Shpenzime për transferta korrente të brendshme (606)**” realizuar në masën 84%. Nga 1,253,331 lekë të alokuara, u shpenzuan 1,046,993 lekë, me diferencë prej -206,338 lekë. *Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 22 (Seksioni Anekse)*.

-Zëri “**Investime, ose shpenzime kapitale (Ilog.230-231)**”, nga 19,000,000 lekë realizuar 18,675,803 lekë ose 98%. *Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 23*.

Nga buxheti i shtetit për vitin 2022 u akorduan 19,000,000 lekë, të cilat fillimisht ishin ndarë në 3,400,000 lekë për paisje kompjuterike, 3,500,000 lekë për paisje zyre, 700,000 për tituj për bibliotekën, si dhe 11,400,000 lekë për rikonstruksionin e sallës së gjyqeve. Pas kryerjes së prokurimeve të parashikuara dhe realizimit të investimeve (*paisje kompjuterike, paisje zyremobilim, tituj për bibliotekën, rikonstruksion*), mbetën pa u shfrytëzuar për shkak të ofertave të paraqitura nga operatorët më të ulta sesa fondi limit, afërsisht 650,000 lekë. Me kërkesën e GJK, vlera është rialokuar nga Ministria e Financave në zërin "Paisje Zyre", në Nëntor 2022. Kjo shumë së bashku me fondin e mbetur në zërin "paisje zyre", rreth 807,000 lekë, u prokurua dhe u realizua në masën 596,400 lekë, të cilat u përdorën për blerjen e disa paisjeve elektrike, 4 kondicionerë të rinj, si dhe 8 televizorë së bashku me mbajtëset murale për zyrat e gjyqtarëve. Për vitin 2022 nga procedurat e prokurimit të zhvilluara është realizuar vlera prej 34,493,187 lekë me TVSH, përjashtuar kontratat për furnizimin me energji elektrike, ujë, telefoni fikse e mobile dhe shërbimin postar,

Harxhimi i shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale të buxhetit të vitit 2022, u bazua në aktet trajtuar në seksionin Anekse.

Bazuar në Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit 115/2021 "*Për buxhetin e vitit 2022*", të ndryshuar, performanca e realizimit të buxhetit të rishikuar, paraqitet shumë e mirë.

Gjykata Kushtetuese për vitin 2022, ka operuar dhe ka menaxhuar fondet buxhetore, publike me një program të vetëm "Veprimtaria gjyqësore kushtetuese". Programi përbëhet nga produktet, performanca e të cilave në terma sasiore dhe monetare paraqitet, si më poshtë:

Produktet me shpenzime korrente që përbëhen nga:

Produkti 1 "Vendime të marra"

Ky produkt për vitin 2022, ishte parashikuar të ishte 300 vendime të marra. Produkti gjatë vitit 2022 është realizuar me 238 vendime në total. Vendimet e marra ndahen në 43 vendime përfundimtare të marra për kërkesa të regjistruara gjatë viteve 2021-2022, si dhe 195 vendime moskalimi për shqyrtim në seancë të marra për kërkesa të regjistruara gjatë viteve 2021-2022. Ky produkt është realizuar në masën 80%.

Shpenzimet korrente për këtë produkt janë realizuar në vlerën 147,275,600 lekë nga 147,762,331 lekë sipas programit të rishikuar ose pothuajse 100%.

"Produktet me shpenzime administrative kapitale"

Produkti "Paisje per zyra"

Realizuar mobilimi i plotë për 8 zyra të gjyqtarëve. Fondi i planifikuar për kompletimin e zyrave dhe sigurimin e kushteve normale të punës sipas programit të rishikuar ishte 4,150,000 lekë realizuar 3,939,120 lekë ose 95%.

Produkti "Bibliotekë e pasuruar"

Nga konsultimi me gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë u hartua një listë me 24 tituj të rinj librash, të cilët pas kryerjes së procedurave të prokurimit i janë shtuar bibliotekës së gjykatës. Fondi i rialokuar për këtë produkt ishte 575,000 lekë, i cili u realizua në vlerën 573,500 lekë ose në masën 100%.

Produkti "Sisteme të informatizuar" (paisje informatike)

Fondi për blerjen e paisjeve informatike ishte planifikuar 3,500,000 lekë, por pas rialokimeve u finalizua në 3,110,000 lekë, realizuar 3,108,000 lekë. Numri i paisjeve për këtë produkt është realizuar tërësisht dhe në përputhje me kërkesat përsa i përket sasive. Paisjet e blera janë 12 laptop, 6 PC, 10 printera bardh e zi, 3 printera me ngjyra, 1 fotokopje multifunksionale, si dhe 8 ups.

Produkti "Rikonstruksion"

Në buxhetin e vitit 2022, GJK iu akordua edhe një fond prej 11,400,000 lekë për rikonstrukcionin e sallës së gjyqeve, e cila pas rialokimeve u finalizua në 11,165,000 dhe realizim në vlerën 11,055,183 lekë.

-Viti 2023, PBA 2023-2025, projektbuxheti viti 2023;

Gjykata Kushtetuese (GJK) ka përgatitur kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm bazuar në Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”.

Me Urdhrin Nr.37, datë 19.04.2023 të titullarit të GJK është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe me Urdhërin Nr.36, datë 19.04.2023 është krijuar Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) për programin 03320 “*Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese*”.

Me shkresën nr.217, datë, 24.09.2022, është përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) projektbuxheti afatmesëm 2023-2025 (faza I) dhe me shkresën nr.495, datë, 31.08.2022, është përcjellë në MFE projektbuxheti afatmesëm 2023-2025 dhe detajimi i projektbuxhetit të vitit 2023, (faza II-të), në programin bazë (03320) “*Veprimtaria gjyqësore kushtetuese*” që përbëhet nga 6 produkte sipas tavaneve të miratuara dhe me 7 produkte sipas kërkesave për politikat e reja.

Kërkesat buxhetore pasqyrohen në programin “*Veprimtaria gjyqësore kushtetuese*” (03320) dhe detajohen në 7 produkte, sipas aktiviteteve të tyre përbërës pasqyruar në Tabelën 24 (seksioni Aneksë).

Me shkresën nr. 844/1, datë, 30.12.2022, është dërguar pranë MFE, detajimi i buxhetit për vitet 2023-2025 si dhe plan thesari i GJK për vitin 2023, pas miratimit të Ligjit Nr.84/2022 “*Për buxhetin e vitit 2023*”.

Me Ligjin Nr.84/2022 “*Për buxhetin e vitit 2023*”, është miratuar buxheti i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2023, në vlerën 170,500,000 lekë me 62 punonjës në organikë.

Ndryshimet buxhetore në vitin 2023.

Buxheti Gjykatës Kushtetuese për vitin 2023 ishte në vlerën 170,500,000 lekë. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) është çelur fondi i veçantë në vlerën +200,000 lekë, referuar Udhëzimit plotësues nr.2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Në përputhje me kërkesat e Gjykatës Kushtetuese, nga MFE janë akorduar edhe fondet për dhënien e shpërblimeve sipas funksionit për dy gjyqtarë që përfunduan mandatin, si dhe për drejtorin e kabinetit të Kryetarit, të cilit i mbaroi afati i kontratës së punësimit, bazuar në Ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “*Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit*”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr. 548, datë 27.07.2016, “*Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit*”. Me VKM nr. 405, datë 05.07.2023 janë akorduar 35,000,000 lekë për rikonstrukcionin e ambjenteve të brendshme të gjykatës. Gjithashtu, për mbulimin e rritjes së shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore, në vijim të ndryshimeve që pësuan strukturat e pagave për të gjithë punonjësit e Gjykatës Kushtetuese (*Vendimi nr 35/2022 i Gjykatës Kushtetuese, VKM nr. 325 dhe 326, datë 31.05.2023 për ndryshimet e pagave të nëpunësve civilë dhe punonjësve mbështetës*), nga MFE u akordua një fond total prej 23,375,000 lekësh, ndërkohë që për mbulimin e plotë të shpenzimeve operative të vitit 2023, u akordua një fond shtesë prej 6,000,000 lekësh (*Akti Normativ nr. 5, datë 12.10.2023*).

Në mënyrë të detajuar shtesat e buxhetit për vitin 2023, jepen në tabelë:

Në lekë

Shpenzime për ndihmë të menjëhershme, etj.-Fondi i veçantë-(Ilog. 606)	200,000
Akordim fondi për pagesën pas ndërprerjes së funksionit-(Ilog. 606)	2,708,262
Akordim fondi për shpenzime kapitale-VKM nr. 405, dt. 05.07.2023-(Ilog. 231)	35,000,000
Akordim fondi për rritjen e pagave gjatë vitit 2023 (Ilog. 600 dhe 601)	23,375,000
Akordim fondi për shpenzimet operative-A. N. nr. 5, dt. 12.10.2023 (Ilog. 602)	6,000,000

Burimi: GJK

Në datën 07.12.2023, Gjykata Kushtetuese ka nënshkruar një marrëveshje me Ambasadën e Zvicrës, për realizimin e e projektit “Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese”, që do të zbatohet gjatë vitit 2024. Ambasada e Zvicrës do të mbulojë shpenzimet e lidhura me realizimin e këtij projekti, nëpërmjet një donacioni në vlerën e 6,636,000 lekë.

Për vitin 2023, buxheti i Gjykatës Kushtetuese për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor nga totali i buxhetit prej 237,783,262 lekë realizoi 203,417,788 lekë, ose 86% të totalit të tij. Në krahasim me vitin 2022, për të njëjtën periudhë (100%), realizimi i buxhetit për vitin 2023 është 14% më pak.

Treguesit kryesorë të buxhetit të Gjykatës Kushtetuese për periudhën Janar-Dhjetor 2023, jepen në Tabelën 25 (seksioni Anekse).

Për vitin 2023, zërat e planifikuar janë realizuar sipas parashikimeve. Anulimi i procedurës të prokurimit për rikonstrukcionin e ambjenteve të brendshme të gjykatës për shkak të mosplotësimit të kriterëve të veçanta nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës në këtë procedurë, është faktori kryesor që ka ndikuar në realizimin e buxhetit të vitit 2023 në masën 86%.

Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit të Gjykatës Kushtetuese, sipas zërave përbërës të tij për vitin 2023, rezultojnë:

-Numri i punonjësve të Gjykatës Kushtetuese në datën 31.12.2023 ishte 62 punonjës me kohë të plotë. Me VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”, Gjykatës Kushtetuese i janë shtuar edhe 2 specialistë arkive me kontratë pune të përkohshme 1 vjeçare, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” neni 20, pika 3.

Struktura organizative e gjykatës me vendimin e fundit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 17, datë 20.11.2023 duhet të jetë me 80 punonjës me kohë të plotë.

Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit të Gjykatës Kushtetuese, sipas zërave përbërës të tij për vitin 2023, rezultojnë:

-Zëri “**Shpenzime operative** (llog. 602)” deri në 31.12.2023 është realizuar në masën 98%. Shpenzimet operative sipas fondit total të akorduar për vitin 2023 zënë 15% e buxhetit vjetor të Gjykatës Kushtetuese. Nga 34,607,000 lekë të akorduara gjatë vitit në buxhet, shpenzimet operative u realizuan në vlerën 33,817,796 lekë me diferencë prej -789,204 lekë.

Realizimi i shpenzimeve operative sipas nën zërave përbërës detajohet si më poshtë:

Grupi i shpenzimeve “**Materiale zyre dhe të përgjithshme** (llog. 602.0)”, nga 4,584,800 lekë u realizua me 4,583,784 lekë ose 100 %, diferencë prej 1,016 lekë. Peshën kryesore të shpenzimeve në këtë grupim e përbëjnë kancelari, tonerat, abonimet në shtypin e brendshëm dhe literaturën e huaj, abonimet e literaturës së huaj (“Human Rights Law Review”, “European Public Law” dhe “International journal of constitutional law”), si dhe materialet e zyrës dhe të përgjithshme ku përfshihen dizenjimi, modelimi dhe prodhimi i spilave për veshjet e gjyqtarëve, prodhimi i stemave të reja të gjykatës, uji i pijshëm, etj.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 26 (Seksioni Anekse).

-Grupi i shpenzimeve “**Materiale dhe shërbime speciale** (llog.602.1)”, nga 2,920,380 lekë u realizua me 2,920,098 lekë ose 100%, diferencë prej -282 lekësh.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 27 (Seksioni Anekse).

Grupi “**Shërbime nga të tretë** (llog.602.2)”, nga 5,264,940 lekë, është realizuar me 5,256,509 lekë ose 100% e tyre, me një diferencë prej – 8,431 lekë. Peshën kryesore në këtë grupim e përbëjnë shpenzimet për energji elektrike, telefoni mobile dhe fikse, shërbimet postare,

trajtime dhe seminare, shërbime etj. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 28 (Seksioni Anekse).

Grupi **“Shpenzime transporti (llog.602.3)”**, nga 8,179,840 lekë, është realizuar me 8,179,832 lekë ose 100%. Në këtë grup përfshihen shpenzimet për karburant, shpenzimet për siguracionet e mjeteve, shpenzimet për pastrimin e automjeteve, shpenzimet për blerje autogoma.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 29 (Seksioni Anekse).

Kuotat mujore të konsumit të karburanteve sipas limiteve të miratuara jepen në Tabelën 30 (Seksioni Anekse).

Në datën 01.01.2023 sasi të e karburantit në magazinë kanë qenë përkatësisht 2,254 litra naftë dhe 2,766 litra benzinë. Sipas parashikimit të nevojave për karburante dhe vlerësimit të tregut, sasi të e pritshme të karburantit për vitin 2023 ishin respektivisht: 21,700 litra naftë dhe 13,385 litra benzinë. Në bazë të kontratës nr. 159/24, datë 20.03.2023 me vlerë 6,600,000 lekë, e amenduar me kontratën nr. 159/34 datë 24.05.2023 (*shtuar nafta me +4,000 litra dhe pakësuar benzina me -4,000 litra*), u blenë përfundimisht 26,942 litra naftë dhe 9,385 litra benzinë nga të cilat 10,000 litra naftë me çmim 187 lekë/litër dhe 8,000 litra benzinë me çmim 185 lekë/litër (*fatura nr. 4048/2023, dt. 25.03.2023*) dhe 16,942 litra naftë me çmim 177.53 lekë/litër dhe 1,385 litra benzinë me çmim 174.84 lekë/litër (*fatura nr.9378/2023, dt.30.06.2023*). Amendimi i kontratës fillestare është bërë duke marrë në konsideratë faktin se me marrjen me qira të 4 automjeteve me naftë për gjyqtarët, shtohet sasia e naftës së konsumuar, ndërkohë që ulej sasia e benzinës.

Nga ndryshimi i çmimit në bursë, është përfituar +1,242 litra naftë më tepër nga sasia e pritshme e përlogaritur në fillim.

Gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 janë konsumuar në total 27,985 litra naftë dhe 5,681 litra benzinë. Në datën 31.12.2023, sasia e karburantit të mbetur është 1,211 litra naftë dhe 6,470 litra benzinë.

“Shpenzime udhëtimi (llog.602.4)”, nga 4,957,714 lekë, është realizuar 4,519,963 lekë ose 91%, diferencë prej -437,751 lekë. Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 31 (Seksioni Anekse).

“Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme (llog.602.5)”, nga 2,377,000 lekë u realizuan 2,366,120 lekë ose pothuajse 100% e tyre, diferencë prej -10,880 lekë.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 32 (Seksioni Anekse).

Grupi **“Shpenzime për qiramarrje (602.6)”**, nga 2,693,176 lekë, u realizua me 2,693,000 lekë ose 100% e tyre. Në këtë grup bëjnë pjesë shpenzimet për qiranë e automjeteve dhe për qiranë e një ambjenti për magazinë. Shpenzimin kryesor e zë marrja me qira e 4 makinave për gjyqtarët në vlerën prej 2,641,000 lekësh. Për marrjen me qira janë lidhur respektivisht kontrata nr. 330/24, datë 28.04.2023 me një afat 6-mujor, si dhe kontrata nr. 993/12 prot., datë 24.11.2023 me afat 3-mujor. Shpenzimi për qiranë e magazinës është në vlerën 52,000 lekë.

Grupi **“Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale (llog.602.7)”**, u realizua në masën 705,074 lekë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 170(80-2023-181), datë 07.02.2023, për pagesën e detyrimit në masën e 2 (dy) pagave kalimtare për 1 ish anëtar Gjykatës Kushtetuese.

Grupi **“Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua (llog.602.8)”** nuk ka veprime të kryera ose pagesa të kësaj natyre.

Grupi **“Shpenzime të tjera operative (llog.602.9)”**, nga 2,923,150 lekë, u realizua me 2,593,072 ose rreth 89%, me një diferencë prej -330,078 lekë.

Në mënyrë të detajuar këto shpenzime jepen në Tabelën 33 (Seksioni Anekse).

Zëri **“Shpenzime për transferta korrente të huaja (llog.605)”**, nga 1,000,000 lekë të akorduara për vitin 2023, deri në 30.06.2023 janë shpenzuar 529,925 lekë. Kjo shumë përbëhet nga tre pagesa. Pagesa e parë 1,000 euro (*117,500 lekë*) e kryer në 16 Mars 2023, përfshin kuotizacionin vjetor për Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese (WCCJ), pagesa e dytë 2,331 euro (*272,727 lekë*) e kryer 27 Mars 2023, përfshin kuotizacionin vjetor që paguan gjykata si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Gjykatave Kushtetuese Frankofone

(ACCF) dhe pagesa e tretë prej 139,698 lekësh e kryer në 27 Mars 2023, përfaqëson kuotën për pjesëmarrje (*regjistrim+akomodim*) në Kongresin e Federatës Ndërkombëtare për të Drejtën Europiane (*FIDE*). Pjesa e pashfrytëzuar e këtij fondi prej 470,000 lekësh është rialokuar në llogarinë 602.

Zëri **“Shpenzime për transfertat të brendshme (llog. 606)”** përbën 1.3% në raport me buxhetin vjetor të Gjykatës Kushtetuese. Nga 3,271,262 lekë, janë shpenzuar 3,118,662 lekë, nga të cilat 2,708,262 lekë janë shpërblimet pas përfundimit të funksionit për dy gjyqtarë dhe drejtorin e kabinetit të kryetarit, 347,150 lekë janë rimbursimet e shpenzimeve telefonike, ndërsa 63,250 lekë janë shpërblim për dalje në pension të një punonjësi.

Zëri **“Investime ose shpenzime kapitale (llog.231)”** përbën 18% në raport me buxhetin vjetor të Gjykatës Kushtetuese. Nga 43,000,000 lekë, u realizua me 9,615,000 lekë ose 22%, me një diferencë prej -34,331,089 lekë. Anullimi i procedurës të prokurimit për rikonstruksionin e ambjentëve të brendshme të gjykatës për shkak të mosplotësimit të kriterëve të veçanta nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës në këtë procedurë, është faktori kryesor që ka ndikuar në realizimin e investimeve në masën 22% për vitin 2023. Të detajuara shpenzimet jepen në Tabelën 34 (seksioni Aneksë).

Për vitin 2023, nga procedurat e prokurimit është realizuar vlera 36,484,689.6 lekë me TVSH duke përfshirë kontratat për furnizimin me energji elektrike, ujë, telefoni fikse dhe lëvizëse/mobile dhe shërbimin postar.

Gjithsej janë realizuar 76 procedura prokurimi për vitin 2023. Për procedurat e prokurimit me objekt *“Auditimin dhe vlerësimin e funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës I.T.”* dhe *“Blerje e shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të autoveturave të Gjykatës Kushtetuese”*, ka pasur ankim nga OE ku për tenderin me objekt *“Auditimin dhe vlerësimin e funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”*, është hequr dorë nga ankimi i bërë në Komisionin e Prokurimit Publik(KPP) nga ana e OE. Ankimet nuk janë pranuar nga KPP (*respektivisht vendimet nr. 567/2023, datë 05.07.2023 dhe nr. 847/2023, datë 04.09.2023*), ndërsa për të gjithë procedurat e tjera nuk ka pasur ankim.

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale të buxhetit të vitit 2023 të kryera, u bazuan në aktet e trajtuara në seksionin Aneksë.

Gjykata Kushtetuese për vitin 2023, ka operuar dhe ka menaxhuar fondet buxhetore publike me një program të vetëm *“Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”*. Programi përbëhet nga produktet, performanca e të cilave në terma sasiorë paraqitet, si më poshtë:

Produktet me shpenzime korrente që përbëhen nga:

Produkti 1, “Vendime të marra” - njësia matëse: numër vendimesh.

Për vitin 2023 kemi 353 vendime të marra, nga të cilat 283 janë vendime moskalimi, ndërsa 70 janë vendime përfundimtare.

“Produktet me shpenzime administrative kapitale”, Projekti 1 “Orendi/Pajisje/Mjete”, që përbëhen nga:

Produkti 1 “Paisje për zyra”-njësia e matjes: copë.

Pas rialokimeve të fondeve për investime, fondi për blerjen e paisjeve të zyrave prej 1,200,000 lekë është prokuruar dhe realizuar në vlerën 1,161,000 lekë.

Produkti 2 “Bibliotekë e pasuruar”-njësia e matjes: nr. tituj librash

Fondi fillestar prej 700,000 lekë, i përcaktuar për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj u rialokua në produktin *“Sisteme të informatizuara”*

Produkti 3 “Automjete të rinovuara”-njësia e matjes: copë

Për këtë produkt nuk ka realizim, pasi nuk janë detajuar fonde në buxhetin e vitit 2023.

“Produktet me shpenzime administrative kapitale”,Projekti 2“Sisteme të informatizuar” që përbëhen nga:

Produkti 1 “Sisteme të informatizuar”

Fondi i rialokuar për këtë produkt është 8,000,000 lekë, i cili pas procedurave të prokurimit u realizua në vlerën 7,705,200 lekë.

Produkti "Rikonstruksion"

Në buxhetin e vitit 2023, me VKM nr. 405, datë 05.07.2023, Gjykatës Kushtetuese i është akorduar fondi 35,000,000 lekë për rikonstruksionin e ambjenteve të brendshme të saj. Procedura e prokurimit u anulua për shkak të mosplotësimit të kriterëve të veçanta nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës në këtë procedurë. Një pjesë e këtij fondi (1,200,000 lekë) u rialokua për blerje paisje zyre, ndërsa një pjesë tjetër (748,800 lekë) u përdor për rinovim dhe mirëmbajtje të godinës.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, realizimin e planit buxhetor, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxheti, t për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua asgjë materiale që të përbëjë mospërputhje me kriteret për zbatimin e buxhetit.

2.2 Auditimi i llogarive vjetore.

“Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Pasqyrat Financiare **viti 2022** (Gjykata Kushtetuese)

Paraqitja dhe raportimi i tyre është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, të MFE Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”.

Aktivi i Bilancit Kontabël 2022 Gjykata Kushtetuese jepet në Tabelën 35(seksioni Anekse)

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 62,420,068 lekë.

Aktivet 77,496,296 lekë

Pasivet 15,076,228 lekë

Aktivet neto 62,420,068 lekë

I.Aktivet Afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 23,350,747 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 526,299 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 8,274,519 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 14,549,929 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 0 lekë.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së bilancit të vitit 2022 është në shumën 526,299 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në shumën 0 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën 0 lekë dhe rubrikën VI “Teprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën 526,299 lekë. (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”)

Për vitin 2022, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës së shpenzimeve e klasës 6 dhe klasës 2, me akt rakordimin e thesarit duke analizuar dokumentat e nxjerjes së llogarive nga thesari për çdo muaj, për shumat e llogarive në çdo muaj dhe në total

për vitin ushtrimor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur, ditari i bankës i vitit 2022 i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çelje) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	7,441,669	8,762,880	(1,321,211)
32	Objekte inventari	832,850	832,850	-
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	8,274,519	9,595,730	(1,321,211)

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Gjykatës Kushtetuese në 31.12.2022 paraqitet në shumën 8,274,519 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 7,441,669 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 832,850 lekë, e pa ndryshuar nga viti i mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Kontabilizimet në llogarinë 327 “Objekte Inventari” për aktive në shumën 832,850 lekë, pa ndryshuar nga viti në vit, gjendje e cila nuk rezulton e analizuar

Situata: Nga auditimi i llogarisë 327 “Objekte Inventari”, rezulton se shuma prej 832,850 lekë është e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe nuk ka të dhëna për secilin aktiv si pjesë përbërëse të kësaj llogarie. Në analitikun e kësaj llogarie nuk ka të dhëna ku të specifikoheshin kërkesat që duhet të përmbajë një aktiv mbi datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes etj.

Për këto aktive nuk ka të dhëna të mjaftueshme ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, gjithashtu ka mangësi, veprime këto jo në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, pika 26 dhe pika 30.

Kriteri: -UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 30;

-Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

Efekti/Ndikimi: Mungesa e analizës për shumën prej 832,850 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatshkurtra, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: -Të merren masa nga ana e Strukturave Drejtuese në Gjykatën Kushtetuese, për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës, për të kryer inventarizimin dhe saktësimin e vlerës prej 832,850 lekë në llogarinë nr.327 “Objekte Inventari”.

-Drejtoria Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar ndër vite në lidhje me këtë llogari, për nxjerrjen e të dhënave për aktivet afatshkurtra si pjesë përbërëse duke i saktësuar dhe analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish, të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet si dhe në inventarin fizik.

Afati i zbatimit Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë e klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	
44	Institucione te tjera publike	0	0	
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	
468	Debitorë të ndryshëm	5,079,082	1,432,020	3,647,062
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	9,470,847	10,629,535	(1,158,688)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	Totali	14,549,929	12,061,555	2,488,374
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	
	Totali	14,549,929	12,061,555	2,488,374

Titulli i gjetjes: Mbi riklasifikimin e detyrimeve të muajit dhjetor 2022, të likuajuara në Janar 2023, të paraqitura si pjesë përbërëse e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 5,079,082 lekë.

Situata: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, për vitin 2022 paraqitet me vlerë kontabël 5,079,082 lekë si dhe në vitin 2021 me vlerë kontabël 1,432,020 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar fatura për mallra dhe shërbime të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Nga auditimi rezulton se nga ana e Drejtorisë Ekonomike në Gjykatën Kushtetuese, detyrimet e prapambetura të cilat janë fatura për mallra dhe shërbime në fund të periudhës ushtrimore për vitin 2022 në shumën prej 5,079,028 lekë janë keqklasifikuar në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, llogari e cila duhet të përfaqësojë debitorë (të trashëguar ndër vite). Shuma prej 5,079,028 lekë duhej të regjistrohej në llogarinë nr.4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit) me kundërparti llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

- Kriteri:** Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika nr.59.
- Efekt/Ndikimi:** Paraqitje jo e saktë e llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, llogari e cila përfaqëson të drejtat ndaj palëve të treta të Institucionit dhe jo detyrimet.
- Shkaku:** Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë kryer riklasifikimet e të drejtave dhe detyrimeve sipas parimeve kontabël.
- Rëndësia:** E Mesme
- Rekomandimi:** Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Drejtoria Ekonomike, për të kryer sistemimet e detyrimeve në kontabilitet në fund të periudhave ushtrimore duke i riklasifikuar ato në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është një llogari që në Pasqyrat Financiare të Sektorit Publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit, për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (*grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit*) me kundërparti llogarinë nr.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Afati i zbatimit Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

Llogaria 4342 “Te tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 9,470,847 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 9,470,847 lekë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 32. Vlera prej 9,470,847 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-409	-
Detyrime ndaj personelit llog 42	6,398,806
Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa llog. 431	1,057,684
Sigurime shoqërore llog.435	1,726,518
Sigurime shëndetësore llog.436	287,839
Totali	9,470,847

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, paraqitet në vlerën 0 lekë, vlera e kësaj llogarie bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, përfaqëson detyrimet e prapambetura për shpenzime të kryera por, të pa likuiduara në vitin ushtrimor, të cilat referuar Pasqyrave financiare të vitit 2022, si në pasiv “llogaritë e klasës 4” dhe në aktiv llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqiten në vlerën 0 lekë, çka do të thotë që nuk ka detyrime të pa likuiduara.

AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në shumën 242,340 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vitin 2021 në shumën 255,095 lekë.

Gjithashtu sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në fund të vitit ushtrimor 2022, llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 2,556,000 lekë e pa ndryshuar nga viti i mëparshëm.

Nr. Ref.	Teprica në fillim	Shtesat gjate vitit	Pakësimet gjate vitit	Teprica ne Fund
----------	-------------------	---------------------	-----------------------	-----------------

Llog .	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
B			3	4	5	6	7	8	9	10
20	2,556,000	2,300,904	255,096	0	12,754	0	0	2,556,000	2,313,659	242,340
201	0	0	0					0	0	0
202	2,556,000	2,300,904	255,096	0	12,754	0	0	2,556,000	2,313,659	242,340
203	0	0	0					0	0	0

Referuar formatit të mësipërm vihet re së për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, nuk kemi patur shtesa dhe pakësime, ku kosto historike paraqitet në vlerën 2,556,000 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 2,313,659 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 242,340 lekë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimet në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për aktive në vlerën kontabël neto prej 242,340 lekë e shumë e cila nuk rezulton e analizuar dhe të jetë pjesë përbërëse e analitikut të kësaj llogarie.

Situata: Nga auditimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, rezulton se në analitikun e kësaj llogarie përbëhet nga “projekte”, por për të cilat nuk ka të dhëna ku të specifikoheshin kërkesat që duhet të përmbajë një aktiv mbi datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes etj.

Amortizimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, ka vazhduar ndër vite për vlerat e mbetura në masën 15%, edhe pse nuk ka patur të dhëna se cilat janë këto projekte dhe nëse investimi përkatës është kryer ose jo.

Për këto aktive nuk ka të dhëna të mjaftueshme të specifikuara për secilin aktiv, gjithashtu ka mangësi pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve, viti i krijimit të tyre, jo në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, pika 26 dhe pika 30.

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 30; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Efekti/Ndikimi: Mungesa e analizës për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” me vlerë kontabël neto në fund të vitit 2022 prej 242,340 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjat Jo-Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacionin financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese në Gjykatën Kushtetuese, të ngrihet një grup pune, për të kryer inventarizimin dhe saktësimin e vlerës së mbetur prej 242,340 lekë në llogarinë nr.202 “Studime dhe Kërkime”.

Drejtoria Ekonomike, të evindetojë dokumentacionin financiar të trashëguar ndër vite për studime dhe projekte të cilat ëshë bërë hyrje në Regjistrat e Aktiveve të Gjykatës Kushtetuese, duke saktësuar përshkrimet e tyre, vitin e hyrjes të projektit, investimet përkatëse nëse janë kryer sipas projekteve të caktuara, në mënyrë të tillë që vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare të jenë të vërtetuara me dokumentacion

të plotë si dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet si dhe në regjistrat e aktiveve.

Afati i zbatimit Menjëherë

AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 53,903,208 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 44,063,878 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 9,839,330 lekë.

Nr. Refe . Llog .	Teprica në fillim			Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
			3	4	5	6	7	8	9	10
II	141,260,212	97,196,333	44,063,878	18,675,803	7,751,812	10,852,365	9,767,704	149,083,650	95,180,440	53,903,208
212	15,754,606	5,112,256	10,642,350	2,435,883	532,117	-	-	18,190,489	5,644,373	12,546,115
214	33,584,483	25,890,620	7,693,863	6,187,200	2,159,821	9,132,742	8,524,172	30,638,940	19,526,269	11,112,671
215	58,050,960	45,038,983	13,011,976	-	2,602,395	-	-	58,050,960	47,641,377	10,409,580
218	33,870,164	21,154,474	12,715,690	10,052,720	2,457,477	1,719,623	1,243,531	42,203,260	22,368,420	19,834,840

Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në shumën 149,083,650 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në shumën 141,260,212 lekë. Llogaritë do të analizohen si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 12,546,115 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën prej 10,642,350 lekë. Referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 18,190,489 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2021, në shumën 15,754,606 lekë, pra me shtesë në shumën 2,435,883 lekë përgjatë vitit ushtrimor 2022. Analitiku i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” përbëhet nga Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese me kosto historike në shumën 15,754,606 lekë, si edhe shtesat e vitit ushtrimor 2022, përbëhen nga Investimi i kryer për Rikonstruksionin e Ndërtesës në shumën 2,435,883 lekë. Investimi përgjatë vitit 2022 përbëhet nga 2 (dy) Urdhër shpenzime si më poshtë të detajuara:

- 1.Urdhër Shpenzimi nr.355, datë 09.12.2022, në vlerën 529,200 lekë.
- 2.Urdhër Shpenzimi nr.368, datë 27.12.2022, në vlerën 1,906,683 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 11,112,671 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 7,693,862 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 33,584,483 lekë dhe në fund të vitit 2022 në koston historike prej 30,638,940 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, gjatë vitit ushtrimor 2022 ka patur shtesa në shumën 6,187,200 lekë. Shtesat kryesisht janë sisteme edhe pajisje kompjuterike të detajuara në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Fletë hyrja	Sasia	Cmimi për njësi	Vlera kontabël
PC Dell Vastro 3888 +monitorDell 2222H	Nr.1, dt. 06.07.2022	6	86,400	518,400
UPS SPS PLL 1000 VA	Nr.1, dt. 06.07.2022	5	14,280	71,400
Printer Brother HL-L6250DN	Nr.1, dt. 06.07.2022	10	27,600	276,000

Laptop Dell Vostro 3515 R7	Nr.1, dt. 06.07.2022	12	97,080	1,164,960
Fotokopjo Canon imege Runner Advance	Nr.1, dt. 06.07.2022	1	983,640	983,640
Printer Brother HL-L8260DË	Nr.1, dt. 06.07.2022	3	31,200	93,600
Sistem kondicionimi lokal aparat freyres tokesor	Nr.3/1 dt. 13.12.2022	1	420,000	420,000
Ndricues mural	Nr.3/1 dt. 13.12.2022	8	32,400	259,200
Sistem audio video sistem sreaming	Nr.3/1 dt. 13.12.2022	1	2,400,000	2,400,000

Gjatë vitit ushtrimor 2022 kemi pakësim të llogarisë në vlerën 9,132,742 lekë, të detajuara si më poshtë:

Përshkrimi	Vlera kontabël
Kalim Kapital Garda	64,800
Kalim Kapital Lezhë	1,746,268
Nxjerrje jashtë përdorimi	7,321,674
Totali	9,132,742

Nga tabela më sipër rezulton se pakësimi i llogarisë ka ndodhur si rezultat e kalimeve kapitale drejt “Gardës” dhe “Lezhës”, si dhe kemi nxjerrje jashtë përdorimi në shumën 7,321,674 lekë. Materialet e nxjerra jashtë përdorimi janë kryesisht pajisje kompjuterike (laptop, kompjuter, printer, monitor, telefona etj.) si dhe pajisje kondicionera.

Llogaria 215 “Mjete transporti”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 10,409,580 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 13,011,976 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 58,050,960 lekë, vlerë e njëjtë edhe për vitin 2022.

Gjatë vitit ushtrimor 2022, nuk ka patur shtesa ose pakësime të kësaj llogarie.

Analitiku i llogarisë .215 “Mjete transporti”

Përshkrimi	Data e Hyrjes	Kosto Historike	Vlera Kontabël Neto 31.12.2021	Amortizimi Vjetor	Amortizimi i Akumuluar	Vlera Kontabël Neto 31.12.2022
W.V.Pasat	2004	2,495,000	148,260	29,652	2,376,391	118,608
Autoveture Mercedes benz	2002	1,475,000	53,202	10,641	1,432,437	42,562
W.V.Pasat	2005	2,495,000	160,129	32,026	2,366,896	128,103
W.V.Pasat	2005	2,495,000	160,129	32,026	2,366,896	128,103
W.V.Pasat	2008	2,988,000	299,401	59,880	2,748,479	239,520
W.V.Pasat	2007	2,494,800	215,490	43,098	2,322,407	172,392
W.V.Pasat	2009	2,988,000	347,332	69,467	2,710,133	277,866
Hyundai Santa Fe	2012	2,994,960	543,543	108,709	2,560,125	434,834
Sirena vendosur tek Hyundai	2012	28,000	4,710	942	24,231	3,768
Hyundai Tuscon	2017	3,450,000	1,413,120	282,624	2,319,504	1,130,496
Mercedes Benz E220	2015	5,940,000	1,807,843	361,569	4,493,725	1,446,274
Mercedes Benz C220	2015	5,460,000	1,661,754	332,351	4,130,596	1,329,403
Mercedes Benz C220	2015	5,460,000	1,661,754	332,351	4,130,596	1,329,403
Mercedes Benz S350	2014	12,319,200	3,231,948	646,390	9,733,640	2,585,559
Mercedes Benz 220ËDD	2014	4,968,000	1,303,355	260,671	3,925,315	1,042,684

Totali	60,349,960	13,011,976	2,602,395	47,641,379	10,409,580
--------	------------	------------	-----------	------------	------------

Analitiku i llogarisë 215 “Mjete Transporti”, përbëhet nga 13 Mjete si dhe përgjatë vitit ushtrimor 2022, nuk ka patur shtesa ose pakësime. Të gjitha mjetet në përdorim nga Institucioni janë amortizuar me normë amortizimi 20% mbi vlerën kontabël neto në fund të vitit 2021. Vlera totale e amortizimit vjetor për vitin 2022 është në shumën 2,062,395 lekë.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 19,834,840 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 12,715,690 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në koston historike prej 33,870,164 lekë dhe në fund të vitit 2022 në koston historike prej 42,203,260 lekë.

Llogaria 218 “Inventar Ekonomik”, gjatë vitit ushtrimor 2022 ka patur shtesa në shumën 10,052,720 lekë. Shtesat kryesisht janë materiale (mobilje, poltrona, karrike, rraafte etj). Këto shtesa të kësaj llogarie janë kryer nëpërmjet fletë hyrjes nr.2, datë 09.12.2022. Gjatë vitit ushtrimor 2022 kemi pakësim të llogarisë në vlerën 1,719,623 lekë, e detajuar si më poshtë:

Përshkrimi	Vlera kontabël
Kalim Kapital Garda	506,548
Nxjerrje jashtë përdorimi	1,213,075
Totali	1,719,623

Nga tabela më sipër rezulton se pakësimi i llogarisë ka ndodhur si rezultat e kalimeve kapitale drejt “Gardës” për materiale me profil drusor nëpërmjet fletë daljes nr.3, datë 24.02.2022 në shumën 506,528 lekë si dhe kemi nxjerrje jashtë përdorimi në shumën 1,213,075 lekë. Materialet e nxjerra jashtë përdorimi janë kryesisht materiale profil drusor (karrike, poltrona, rraafte etj.) si dhe pajisje elektrike (neona, ndriçuesat etj.), të nxjerra jashtë përdorimi me fletë daljen nr.11, datë 07.07.2022.

Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën (7,764,567) lekë.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo aktiv. Referuar tabelës formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, totali i amortizimit për vitin 2022 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej (7,764,567) lekë, duke debituar llogarinë 1013 “Nga konsumi i AAGJ” (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në kredi të llogarive nr.2192 “Amortizimi ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 532,117 lekë, llogarisë nr.2194 “Amortizim makineri dhe paisje” në vlerën 2,159,821 lekë, llogarisë nr.2195 “Amortizim mjete transporti” në vlerën 2,602,395 lekë dhe i llogarisë nr.2198 “Amortizim inventar ekonomik”, në vlerën 2,457,477 lekë.

Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2022, Gjykata Kushtetuese.

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Gjykatën Kushtetuese.

Gjatë vitit 2022, me urdhrin e Titullarit të Gjykatës Kushtetuese, nr.124 datë 21.12.2022, për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe nxjerrjes jashtë përdorimi për të gjitha asetet e Institucionit për vitin 2022.

Inventarizimi është kryer nga data 16.01.2023 deri në datën 16.02.2023

Komisioni i Inventarizimit ka hartuar raportin përfundimtar të shoqëruar me pasqyrat përkatëse duke krahasuar të dhënat nga gjendja kontabël me gjëndjen fizike për secilin aktiv, sipas personave në ngarkim. Gjithashtu Komisioni ka propozuar nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të cilat në kushtet aktuale kanë humbur vlerën e tyre të përdorimit ose nuk mund të përshatashin me kushtet konkrete të punës në Gjykatën Kushtetuese. Raporti i hartuar nga Komisioni i është paraqitur Nëpunësit Zbatues dhe Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Aseteve me nr.203 prot, datë 16.02.2023, si dhe i është dërguar raporti përmbledhës komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi (i ngritur me urdhrin nr.125, datë 21.12.2022).

Transferimet Kapitale.

-Referuar Urdhrit të përbashkët nr.9, datë 17.02.2022, midis Gjykatës Kushtetuese dhe Gardës së Republikës, janë kryer transferime kapitale të aktiveve në shumën 571,348 lekë, bazuar në konfirmimet e marrjes në dorëzim me nr.99/3, datë 01.03.2022 dhe 326/1, datë 01.03.2022 si dhe me fletë hyrjen e Gardës së Republikës me nr.1, datë 24.02.2022 dhe fletë daljen nr.3 të Gjykatës Kushtetuese, ku janë të përshkruar aktivet me koston historike, amortizimin e akumuluar dhe vlerën kontabël neto në 31.12.2021.

-Referuar Urdhrit të përbashkët nr.33/2, datë 16.03.2022, midis Gjykatës Kushtetuese dhe Bashkisë Lezhë, janë kryer transferime kapitale të aktiveve në shumën 1,746,269 lekë, bazuar në konfirmimet e marrjes në dorëzim me nr.33/4, datë 24.04.2022 dhe 3644/1, datë 25.03.2022 si dhe me fletë hyrjen e Bashkisë Lezhë me nr.2, datë 25.03.2022 dhe fletë daljen nr.6 të Gjykatës Kushtetuese, ku janë të përshkruar aktivet me koston historike, amortizimin e akumuluar dhe vlerën kontabël neto në 31.12.2021.

Nxjerrjet jashtë përdorimi.

Referuar Urdhrit me nr.219/15, datë 31.08.2023, janë përmbledhur pagesa e shërbimit të asgjesimit, ftesa për vlerësim me nr.219/3, datë 12.05.2022 si dhe me Urdhrin nr.41, datë 11.12.2020 është ngritur Komisioni i Nxjerrjes jashtëpërdorimi, i cili ka hartuar relacionin nr.219 datë 04.05.2022, ku ka përshkruar aktivet që do nxirren jashtëpërdorimi me kosto historike në shumën 8,534,749 lekë, e përbërë nga materialet e llogarisë 214 me kosto historike në shumën 7,321,673 lekë amortizim të akumuluar (6,884,476) lekë dhe vlerë kontabël neto 437,196 lekë dhe materialet e llogarisë 218 me kosto historike në shumën 1,213,075 lekë, amortizim të akumuluar (882,864) lekë dhe vlerë kontabël neto 330,210 lekë, të detajuara edhe me fletë daljen nr.11, datë 07.07.2022

PASIVET (DETYRIMET). Pasivi i Bilancit Kontabël 2022 Gjykata Kushtetuese jepen në Tabelën 36 (seksioni Anekse).

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Gjykatës Kushtetuese më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë	Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
42	Detyrime ndaj personelit	6,398,806	6,057,547	341,259
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,057,684	2,704,971	(1,647,287)
435	Sigurime shoqërore	1,726,518	1,593,409	133,109
436	Sigurime shëndetësore	287,839	273,609	14,230
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	526,299	-	526,299
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	5,079,082	1,432,020	3,647,062
	Gjendja më fund të periudhës	115,893,411	93,945,724	3,014,672

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Gjykatës Kushtetuese, paraqitet në vlerën 6,398,806 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatsisht në vlerat 1,726,518 lekë dhe 287,839 lekë.

Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 526,299 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga Rikonstruksioni i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese dhe fondi gjendet i ngurtësuar deri në 31.12.2022

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin”, nga pasqyra e pozicionit financiar për vitin 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël prej 5,079,082 lekë, e cila ka si kundërparti llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit sipas të dhënave të paraqitura nga Sektori i Financës.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 62,420,068 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 53,914,703 lekë.

Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve në vlerën 77,496,296 lekë me pasivet në vlerën prej 15,076,228 lekë.

33	D	FONDI I KONSOLIDUAR:	62,420,068	53,914,703
34	101	Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficit i Akumuluar	63,741,279	55,356,397
35	12	Rezultatet e mbartura		
36	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	(1,321,211)	(1,441,694)
37	111	Rezerva		
38	115	Nga Fondet e veta të Investimeve		
39	15	Shuma të parashikuara për rreziqe dhe zhvlerësime		
40	105	Teprica e Granteve kapitale të brendshme		
41	106	Teprica e Granteve kapitale të huaja		
42	107	Vlera e mjeteve të caktuar në përdorim		
43	109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
		Të tjera		
44	E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	77,496,296	65,976,259

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2022 (grant) paraqitet në shumën prej 146,866,919 lekë.

Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit.

Pesha specifike e shpenzimeve pasqyrohet si më poshtë: Shpenzimet për llogarinë nr.600 “Paga shpërblime të tjera personeli”, në vlerën 108,939,918 lekë janë rreth 73% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë nr.601 “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 11,505,588 lekë rreth 7% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë 602 “Mallra dhe shërbimet të tjera” në vlerën 23,930,446 lekë rreth 16% e totalit, shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 1,796,993 lekë zënë 2% të totalit të shpenzimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.154/9, datë 20.03.2024 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, ku ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Për llogarinë 327 Objekte inventari, në vijim të observacionit të mëparshëm nga ana e sektorit të financës, kjo llogari mbahet me kartela për çdo emërtim në sasi, çmim, vlerë dhe vendndodhjes, sipas Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” por duke qenë se kjo llogari është e krijuar para vitit 2010, të dhënat për datën e blerjes, dhe marrjen në dorëzim nuk janë analitike. Si për çdo aktiv material të pasqyruar në pasqyrat financiare të institucionit, dhe për këtë llogari, kryhet në mënyre periodike, çdo vit kalendarik inventari fizik sipas kartelave kontabël, me sasi, çmim dhe vlefë sipas personit përgjegjës dhe vendndodhjes në momentin e inventarit. Nga krahasimi i gjendjes kontabile me atë fizike në asnjë rast nuk kanë rezultuar diferencat në sasi. Në të ardhmen komisionet e inventarizimit, do të vlerësojnë vlerën e tyre të përdorimit aktuale dhe do të dalin me propozimet përkatëse , të cilat do të pasqyrohen sipas procedurave në pasqyrat financiare në vazhdim.

2.Për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” të vitit 2022 është lënë konstatimi: shuma prej 5,079,028 lekë duhej të regjistrohej në llogarinë 4342 Operacione me shtetin. Duke qenë se llogaritë në bilanc, kanë një vazhdimësi nga viti në vit, llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm” ka ardhur vit pas viti, dhe kjo llogari është e konceptuar si detyrim që dega e thesarit ka në fund të cdo viti, për faturat e muajit Dhjetor të kaluar në janar të vitit pasardhës.

Mbështetur në standardin për sistemimin dhe pozicionimin korrekt të llogarive, me mbylljen e bilancit të vitit 2023, kjo shumë do të sistemohet që në çeljen 01.01.2023 dhe në vazhdimësi detyrimet e degës së thesarit në fund të çdo viti do të paraqiten në llogarinë 4342 për shumën totale të faturave, dhe analitike në pasiv të bilancit sipas natyrës së shpenzimit .(llogaritë 401-408)

3.Për aktivet Afatgjata jo materiale është lënë konstatimi për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” dhe llog.212 “Ndërtesa” nuk ka të dhëna të mjaftueshme për datën e hyrjes dhe marrjen në dorëzim. Nga ana e Sektorit të Financës janë mbajtur në kartela të veçanta sipas llogarive të mësipërme, me vlerën përkatëse, dhe për çdo vit është bërë llogaritja e amortizimit dhe vlerës neto të këtyre aseteve. Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion të gjithë korrespondencën me Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Drejtësisë për vënien në dispozicion të ambienteve për sistemimin e Gjykatës Kushtetuese, urdhrat dhe vendimin e KM për kalimin në përgjegjësi administrimi. Sa me sipër ky dokumentacion do bashkëlidhet në pasqyrat financiare të vitit 2023, për të plotësuar pasqyrën e aseteve me të dhënat përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:1.Në lidhje me komentin e subjektit mbi konstatimin për llogarinë 327 “Objekte Inventari”, nga ana e Grupit të Auditimit është evidentuar fakti se kjo llogari paraqitet nga viti në vit e pa ndryshuar si edhe shuma prej 832,850 lekë ka ardhur e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe nuk ka pasqyre analitike fakt i cituar edhe në komentin e subjektit. Nga ana e Grupit të Auditimit është hartuar rekomandimi përkatës për evidentimin e kësaj shume, saktësimin e vlerës në pasqyrat financiare si dhe ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e kësaj llogarie, ku edhe nga ana juaj është pranuar në komentin përkatës.

2.Në lidhje me konstatimin mbi llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, është pranuar nga subjekti si dhe do të kryhen rregullimet përkatëse.

3.Në lidhje me komentin e subjektit mbi konstatimin për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime”, nga ana e Grupit të Auditimit është evidentuar fakti se kjo llogari nuk paraqitet me pasqyrë analitike. Nga ana e Grupit të Auditimit është hartuar rekomandimi përkatës për evidentimin e kësaj shume, saktësimin e vlerës në pasqyrat financiare si dhe ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e kësaj llogarie. Në këto kushte, komenti **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 3 të Programit të auditimit Nr.1036/2, datë 14.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare.
- Pagesa për shërbime e mallra/shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- *Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.*
- *Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës dhe arkës.

Auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion transaksionet financiare për periudhën qershor, korrik, dhjetor 2021-2022-2023, si periudhë me fluksion më të madh të transaksioneve/veprimeve.

Nga auditimi:

Mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara nga Sektori i Financës në përbërje të Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore, (Gjykata Kushtetuese) rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, date 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik*" i ndryshuar, Ligjit 83/2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*".

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (*si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve*) dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.06-30.06.2021 janë në vlerën totale 12,898,594.80 lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.07-30.07.2022 janë në vlerën totale 13,539,814.20 lekë

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.12-31.12.2021 janë në vlerën totale 20,953,594 lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.06-30.06.2022 janë në vlerën totale 10,729,567 lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.07-30.07.2022 janë në vlerën totale 14,956,541 lekë.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.12-31.12.2022 janë në vlerën totale 31,857,506 lekë

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.06-30.06.2023 janë në vlerën totale 16,419,169 lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për periudhën 01.07-30.07.2023 janë në vlerën totale 21,657,564 lekë.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës përperiudhën 01.12-31.12.2023 janë në vlerën totale 26,913,250 lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditori transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara në periudhën Qershor, Korrik dhe Dhjetor të vitit 2021-2022-2023.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të Udhëzimit të Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” i ndryshuar, veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Nga auditimi rezultoi:

-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

- Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë u përdorën teknikat e auditimit si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2021 u konstatua se likuidimi i urdhër shpenzimeve është kryer në masën 7.62% në muajin Qershor, 9.52% në muajin Korrik dhe 21.59% në muajin Dhjetor, në total prej 38.73% për vitin 2021.

Për vitin 2022, likuidimet e kryera në muajin Qershor janë në masën 6.47%, për muajin Korrik 7.67% dhe për muajin Dhjetor përbëjnë 17.99% të shpenzimeve të gjithë vitit, në një total prej 32.13% për vitin 2022.

Për vitin 2023, likuidimi i urdhër shpenzimeve është kryer në masën 10.83% në muajin Qershor, 13.59% në muajin Korrik dhe 13.36% në muajin Dhjetor, në total prej 37.79% për vitin 2023.

Nga auditimi me zgjedhje të urdhër shpenzimeve rezultoi:

Në kuptimin e VKM Nr.50, date 05.02.2014, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/marrëveshje/vendim gjykate të formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo ligj.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ka pasur detyrime të prapambetura nga ana e Gjykatës Kushtetuese, përveç një rasti i cili nuk përbën fenomen të përhapur dhe cdo veprim është kryer në afatet e parashikuara sipas ligjit.

Në këtë kuptim, grupi i auditimit me zgjedhje kreu testimet për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën qershor, korrik dhe dhjetor për vitet 2021-2022-2023 me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit.

Ligji Nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.*

Konstatim: Nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, rezultoi në 1(një) rast shkelje të disiplinës buxhetore, Urdhër Shpenzimi Nr.130, datë 05.07.2021 ku është tejkualuar afati ligjor parashikuar prej 30 ditë, në likuidimin e faturës, jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor” i ndryshuar neni 52 ku citohet se “*Nëpunësi*

zbatues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së” si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, i cili nuk është fenomen i përhapur.

2.4 Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit, si dhe shkresës së Gjykatës Kushtetuese nr. 1302 prot., datë 22.12.2023 (Nr.1036/3, datë 22.12.2023 prot.KLSH) me të cilën kërkohet auditimi i 2 procedurave të prokurimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dosjet e prokurimit me object: “Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese”, viti 2022 dhe “Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve, sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT” viti 2023.

-Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

-Urdhër shpenzimet e kryera nga Sektori i Financës në zbatim të kontratave të lidhura.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

-Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.)

-Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.)

Nga auditimi i procedurës së prokurimit:

“Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.87, Datë 23.09.2022	3.HDT/Njësia e prokurimit Urdhër Nr. 87, Datë 23.09.2022 E. T. R. K. N. M.	4.KVO Urdhër nr.88, datë 23.09.2022 G. M. R. H O. T.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T.Hapur e thjeshtuar”.		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 9,500,000 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 9,303,350 lekë	7.Diferenca me fondin limit 196,650 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 10.10.2022	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës (1). BOE "A.a &M. K." (fitues)

Burimi: Të dhënat GJK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim- Bazuar në shkresën Nr. 504, datë 07.092022 nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes ku është kërkuar rikonstruksioni i sallës së gjyqeve, pasi pajisjet e saj janë të armortizuara dhe nuk krijojnë kushte të përshtatshme pune, është planifikuar nevoja për prokurimin e punimeve (rikonstruksion) e cila është publikuar nga APP në regjistrimin e parashikimeve hartuar nga Autoriteti Kontraktor (AK), ku vlera e llogaritur e fondit limit është 9,500,000 lekë.

Llogaritja e fondit limit-Me Urdhërin Nr.84, datë 15.09.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është ngritur grupi i punës/komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike. Në përbërjen e grupit për llogaritjen e fondit limit si dhe në Njësinë e Prokurimit, bën pjesë dhe specialisti i fushës (N. M) i cili rezulton të jetë specialist i jashtëm/ARRSH. AK, me shkresën Nr.134, datë 08.03.2022 ka bërë kërkesë pranë ARRSH-së për specialist për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese”, e cila është miratuar nga ARRSH me shkresën Nr.3536/1, datë 23.03.2022 duke vënë në dispozicion ing. N. M.. Me specialistin është lidhur kontrata e shërbimit Nr.134/3, datë 14.09.2022 bazuar në VKM Nr.720, datë 29.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”.Njësia e Prokurimit për llogaritjen e fondit limit i është referuar studimit paraprak të tregut në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 35 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 12,13 dhe 76, duke marrë oferta nga 4 operatorë ekonomikë dhe llogaritur mesataren e tyre.

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 77, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar është nxjerrë Urdhër Prokurimi Nr. 87, datë 23.09.2022 në të cilin është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Njësia e prokurimit ka hartuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim bazuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar (procesverbali Nr.504/6, datë 23.09.2022).

Titulli i gjetjes: Vendosije e kriterit “kamera termike” në Dokumentet e tenderit, pa analizuar qëllimin e funksionit dhe jo në raport me objektin e kontratës.

Situata: Në kriteret e veçanta, pika 2.3.7, (mjetet/pajisjet) AK ka kërkuar nga OE që të disponojë “kamera termike”. Kriteri i kërkuar nuk është analizuar nga AK mbi domosdoshmërinë e disponimit nga operatorët dhe nuk është në përputhje me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve të parashikuar në preventiv. Pajisja e kërkuar ka si funksion survejimin e objekteve dhe në kushte të errësirës. Objekti i kontratës, kriteret e DT si dhe preventivi i publikuar, nuk parashikon domosdoshmërinë e kësaj pajisjeje nga OE, veprim jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 35, pika 2 dhe 3 ku përcaktohet qartë se:

“2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor”, si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 39, pika 4 dhe pika 6, germa ”d”, ku përcaktohet:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

“6/d. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon...mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Kriteri: -Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 35, pika 2 dhe 3;

-Dokumentet e tenderit miratuar me procesverbalin Nr.504/6, datë 23.09.2022, pika 2.3.7;

-VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 39, pika 4 dhe pika 6, germa ”d”.

Efekti/Ndikimi: Kufizim i pjesëmarrjes së operatorëve në tenderim.

Shkaku: Vendosije e kriterit “kamera termike” në Dokumentet e tenderit, pa analizuar qëllimin e funksionit dhe jo në raport me objektin e kontratës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Njësia përgjegjëse për prokurimin, që në të ardhmen, përgatitja e dokumenteve të

tenderit/kriteret e veçanta, të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor dhe të jenë të analizuar në detaj, me qëllim që të jenë në proporcion me objektin e kontratës dhe të rrisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në prokurime.

Afati i zbatimit Në vijimësi

Vlerësimi i Ofertave-Në hapjen publike të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit (SEP) rezulton të ketë shpallur interes dhe paraqitur ofertë vetëm 1 OE:

-BOE "A.a&M.K" me vlerë 9,303,350 lekë pa TVSH, i cili është shpallur fitues nga KVO.

Titulli i gjetjes: Mos shqyrtimi në mënyrë të plotë i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët dhe mos pasqyrim i shqyrtimit të dokumentacionit të OE, në procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit nga KVO.

Situata: Nga auditimi në SPE dhe dokumentacionit fizik rezulton se:

-shtojca 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", i cili plotësohet nga të gjithë operatorët e BOE, ka mungesë informacioni në plotësim, pasi nga 2OE, nuk është plotësuar përgjigja për pjesën 1. A. Secili nga OE nuk ka shënuar se me cilin ka hyrë në marrëdhënie bashkëpunimi, jo në përputhje me DT, Shtojca 8, pjesa I, pika A; Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, neni 82, pika 2.

-referuar vertetimit nr.7022/1, datë 04.10.2022 lëshuar nga OSHEE për OE "A.a" rezulton se shoqëria në sistemin e faturimit të mos ketë kontratë me OSHEE. Nga KVO nuk është kërkuar sqarim, pasi kjo shoqëri në QKB rezulton të ketë regjistruar seli e për rrjedhojë duhet të ketë dhe një kontratë furnizimi me energji, si dhe nëse oferta ndodhet në kushtet e "devijimit" të vogël, duke mos e përshkruar këtë veprim në procesverbalin e shqyrtimit të ofertave jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa "i" ku përcaktohet se:

"2. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal..."

i. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material" si dhe neni 2, pika 2.

-licenca e projektimit për administratorin e shoqërisë "A.a" është për kategorinë 2b "*projektim objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara*", jo në përputhje me DT, pika 2.3.2.c megjithëse është kërkuar licencë projektimi për shoqërinë dhe jo për administratorin.

-kontrata datë 10.02.2021 lidhur mes zhvilluesit të pronës B. M. dhe shoqërisë ndërtuese "M.K." me object ndërtimin e strukturës ku do të zhvillohet veprimtari agroturizmi blegtoral, nuk plotëson kushtet për punë të ngjashme në zbatim, pasi objekti i tenderimit ka të bëjë me rikonstruksion e sallës së gjyqeve dhe jo strukturë agroturizmi të cilat nga pikëpamja teknike nuk janë të ngjashme, jo në përputhje me DT, kriteri 2.3.1.a.

-Nga BOE nuk është paraqitur kontratë bashkëpunimi jo në përputhje me DT, pika 2.3.2.b, për zbatimin e punimeve nga OE M.K., që sipas marrëveshjes së bashkëpunimit datë 07.10.2022 merr përsipër të realizojë 94.3% të punimeve të zbatimit, por është paraqitur vetëm Deklarata datë 10.10.2022 e administratorëve respektivë të BOE. Në pikën 6, deklarata parashikon që për realizimin e shërbimit të projektimit dhe të zbatimit të punimeve elektrike shoqëria "A.a." do të bashkëpunojë me shoqërinë

“A.A.”. Pas shqyrtimit të observacioneve rezulton se në pikën 4 të deklaratës parashikohen punimet e ndërtimit të kryhen nga drejtuesi teknik i OE M, ing. A.G., duke përmbushur kështu kushtet e bashkëpunimit, fakt i cili u reflektua në këtë Raport.

Mos paraqitja dhe mos plotësimi i njërit prej kritereve përbën kusht skualifikimi për operatorin/BOE.

Kriteri:

-Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 82, pika 2;

-Dokumentet e tenderit miratuar me procesverbalin Nr.504/6, datë 23.09.2022, Shtojca 8, pjesa I, pika A;

-VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 2, pika 2. neni 39, pika 4 dhe 6, germa ”d”.

Vlerësim jo i plotë i kritereve të DT.

Efekti/Ndikimi:

Shkaku:

Mos shqyrtimi në mënyrë të plotë nga KVO i dokumentacionit të operatorit ekonomik.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, që në të ardhmen shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje me kriteret e kërkuara në çdo detaj të tyre dhe në tërësi, si dhe çdo sqarim i marrë nga operatorët gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të reflektohet në procesverbalin e mbajtur prej saj.

Afati i zbatimit Rast pas rasti

Lidhja dhe zbatimi i kontratës-Me BOE “A.a&M.K.” fitues është lidhur kontrata Nr.504/21, datë 08.11.2022 me vlerë 9,303,350 lekë paTVSH/11,164,020 lekë me TVSH.

Me Urdhërin Nr.101, datë 08.11.2022 të SP është caktuar personi për ecurinë e zbatimit të kontratës. (L.S) Komisioni (A.S, A.N dhe E.T) me procesverbalet respektivë kanë marrë mallrat objekt kontrate në dorëzim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.154/9, datë 20.03.2024 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, ku ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “... me autorizimin nr.954 prot., datë 12.10.2023... kishte nisur auditimi i brendshëm për procedurën “Rikonstruksion i Sallës së Gjqeve në Gjykatën Kushtetuese”. Nga auditimi i brendshëm u konkluduan këto gjetje:

1.Mungesa e argumentimit të zgjedhjes së kontratës me çelësa në dorë dhe mos miratimi i projekt preventivi nga GJK.... Projekt preventivi i plotë është bërë nga kontraktori, por nuk është miratuar nga AK pas nënshkrimit të kontratës....”.

2.Mungesë aprovimi paraprak me shkrim nga AK(GJK-së) i nënkontraktorëve të OE.Në kontratën e lidhur për rikonstruksionin e sallës së gjyqeve...thuhet që: “nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim nga AK..”....Në dosjen e dokumentacionit të kësaj procedure nuk ka dokument që aprovon paraprakisht nënkontraktimin nga AK...”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Në lidhje me **komentin 1**, të bërë nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Në periudhën objekt auditimi, njësia e auditimit të brendshëm i këtij subjekti ishte në fazë të përgatitjes së Projektraportit të Auditimit. Auditimi i KLSH ishte i pavarur në kushtet kur nuk ishte miratuar Raporti Final i Auditimit, në mënyrë që të bëhej vlerësimi i auditimit mbi gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga AB i Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu auditimi u krye mbi bazën e dosjes së auditimit të vënë në dispozicion nga Zyra e Arkivit me datë 09.01.2024 dhe dorëzuar me datë 29.01.2024 nga grupi i auditimit. Nga shqyrtimi i Raportit Final të auditimit bashkëngjitur observacioneve si dhe komenteve të bëra nga subjekti, pas

shqyrtimit të tyre si dhe nga sqarimet e dhëna në takimin e mirëkuptimit organizuar në KLSH datë 12.04.2024, me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese rezultoi se: Bazuar në VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Neni 13, pika 1, AK/Gjykata Kushtetuese me Urdhërin Nr.84, datë 15.09.2022 (Sekretarit të Përgjithshëm) ka ngritur grupin e punës/komisionin për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike, në përbërje të të cilit, bën pjesë dhe specialisti i fushës (i jashtëm i kontraktuar). Nga shqyrtimi në dosjen e prokurimit të Raportit Nr.504/3 Prot, datë 22.09.2022 për llogaritjen e fondit limit, rezultoi se i është dërguar 4 OE me e-mail(nga Kryetari i grupit) “kërkesë për preventiv dhe ofertë”, sipas preventivit shoqërues.Preventivi i administruar në dosjen e prokurimit është i miratuar nga titullari i AK(Sekretari i Përgjithshëm).Në Raport citohet se “preventivi në lidhje me këtë projekt është paraprak...Projekti i plotë i zbatimit do të bëhet nga Kontraktori dhe miratohet nga AK pas nënshkrimit të kontraktës... kjo kontratë do të trajtohet si një kontratë me celësa në dorë, ku vëllimi i punimeve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim...pa kërkuar asnjë fond shtesë...”. Nga përmbajtja e shkresës, rezulton se nuk është dhënë argument i qartë dhe i plotë për arsyet e përzgjedhjes së kësaj procedure. Në këto kushte, komenti i subjektit **merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

VKM Nr.285, datë 19.05.2021 e ndryshuar, neni 39, pika 1,b,germa “i,i” parashikon rastet kur punët publike mund të prokurohen me celësa në dorë dhe konkretisht: “Punët publike mund të prokurohen: Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe **terma reference** për objektin që prokuron. Në këtë **rast**, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor”. Në lidhje me kërkesën e AK që “Projekti i plotë i zbatimit do të bëhet nga Kontraktori dhe miratohet nga AK pas nënshkrimit të kontraktës...” sjellim në vëmendje se, në kuptimin literal neni 39, pika 1,b,germa “i,i” i sipër cituar, kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij dhe jo pas nënshkrimit të kontraktës siç është cituar në Raportin Nr.504/3 Prot, datë 22.09.2022 për llogaritjen e fondit limit,.

Bazuar sa sipër, AK ka nxjerrë urdhër prokurimin.Pas shpalljes publike të njoftimit të kontratës, OE i vetëm pjesëmarrës ka paraqitur projektpreventivin me çmime dhe me ofertë me një diferencë prej 196,650 lekë nga fondi limit duke u shpallur fitues. AK e ka pranuar projektin e tij duke lidhur kontratë e cila është realizuar pa asnjë fond shtesë dhe punët janë marrë në dorëzim duke iu mbajtur e ngurtësuar garancia e punimeve. Projekti i zbatimit paraqitur nga OE fitues, është pranuar nga AK dhe në heshtje quhet i miratuar, për vetë faktin se me OE është nënshkruar kontratë. Në këto kushte, komenti i subjektit **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit për të cilën KLSH jep rekomandimin: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, që në të ardhmen në procedurat e prokurimit për punë publike, të argumentohet qartë dhe në mënyrë të plotë zgjedhja e kontratës me celësa në dorë.

Në lidhje me **komentin 2**, sqarojmë se: Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të BOE datë 07.10.2022, neni 5 përcakton në mënyrë eksplicite se “Shoqëria”A.a” dhe administratori A.B.ka të drejtën e përfaqësimit për të kryer të gjitha veprimet e tjera të nevojshme dhe të domosdoshme për ofertim, për lidhje apo nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, si dhe gjatë zbatimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të objektit...

Shoqëria”A.a” dhe administratori i saj A.B. ka të drejtën e nënshkrimit të gjitha kontratave të bashkëpunimit, por do të konsiderohen si të nënshkruara nga bashkimi i operatorëve”.

Në vijim në Deklaratën datë 10.10.2022 të përfaqësuesit të BOE z.A.B. në pikën 6 citohet “Për realizimin e shërbimit të projektimit dhe zbatimit të punimeve elektrike Shoqëria ”A.a” do të bashkëpunojë me shoqërinë “A.A.”, ku bazuar në kontratën e bashkëpunimit do të angazhojë ing.A.J....i certifikuar me licencat përkatëse...”. Kontrata e bashkëpunimit është lidhur datë

07.10.2022 me shoqërinë “A.A.”, përfaqësuar nga z.A.J. në cilësinë e administratorit për shërbimin e projektimit dhe zbatimit. Në këto kushte, oferta që në publikimin e saj ka parashikuar në deklaratën e bashkëpunimet kontraktimet përkatëse në emër dhe për llogari të BOE të bërë nga “Shoqëria”A.a” për lidhje apo nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, si dhe gjatë zbatimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të objektit. Për pasojë, komenti **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit. Përsa i takon konstatimit të KLSH se nga “BOE nuk është paraqitur kontratë bashkëpunimi jo në përputhje me DT, pika 2.3.2.b, për zbatimin e punimeve nga OE M. K.”, pas shqyrtimit të deklaratës datë 10.10.2022 rezulton se, në pikën 4 parashikohet që punimet e ndërtimit të kryhen nga drejtuesi teknik i OE M. K, duke përmbushur kështu kushtet e bashkëpunimit, fakt i cili u reflektua në këtë Raport.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit:

“Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “Auditimi i dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.22, Datë 12.05.2023	3.HDT/Njësia e prokurimit Urdhër Nr. 22, Datë 12.05.2023 A. H. R. K. K. S. Urdhëri Nr.38, datë 27.04.2023 (llog.f. limit) E. T. K. S. B. Ll.	4.KVO Urdhër nr.41, datë 15.05.2023: L. S. E. K. A. S.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “T. Hapur e thjeshtuar”.		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 3,333,300 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSH) 3,166,000 Lekë	7.Diferenca me fondin limit 167,300 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.05.2023	9.Fonde të Buxhetit Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës (2). "F" Ë" (fitues)

Burimi: Të dhënat GJK dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim- Komisioni për përgatitjen e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike në relacionin Nr.33/5, datë 09.05.2023 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm (SP) ka argumentuar ndryshimet e kërkuara në regjistrin e parashikimeve. Ndryshimet në regjistër janë bazuar në kërkesën Nr.411, datë 26.04.2023 të Drejtorisë Gjyqësore dhe Dokumentacionit drejtuar Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues.

Titulli i gjetjes: Mungesa në dosjen e prokurimit e analizës/raportit teknik, mbi vlerësimin e gjendjes aktuale të sistemeve IT, si nevojë për planifikimin e tenderit dhe pjesë përbërëse e dokumentacionit të dosjes së prokurimit.

Situata: Kërkesa Nr.411, datë 26.04.2023 është bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr.158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve on line nga data 01.01.20220”, në Urdhërin e Kryeministrit Nr.202, datë 16.12.2005”Për forcimin e transparencës, nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit” i ndryshuar, nevojës dhe kërkesave të paraqitura për sigurimin e ruajtjes nga sulmet kibernetike të jashtme dhe të brendshme, **pas evidentimit të gjendjes aktuale të sistemeve IT.** Për këtë qëllim është kërkuar të bëhet auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve e sigurisë së sistemeve IT si më poshtë: raporti i gjendjes aktuale, raporti i nevojave për digjitalizim

dhe testim i sigurisë (*penetration testin*). Në kërkesën Nr.411, datë 26.04.2023, nuk është parashtruar nga kush është bërë evidentimi i gjendjes aktuale të sistemeve IT dhe ku është trajtuar në mënyrë të detajuar ky fakt, por shprehet në përgjithësi nevoja për kryerjen e këtij planifikimi, duke mos u bashkangjitur analiza/raporti teknik i vlerësimit gjendjes aktuale të sistemeve IT, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1, pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1, në të cilat përcaktohet qartë se:

Neni 21, pika 2: *“Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.”*

Neni 35, pika 1: *“...Përpara se të nisin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim. Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mos diskriminimit dhe transparencës.”*

VKM Nr.285;

Neni 2, pika 1: *“Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera”.*

Neni 2, pika 2, germa “a”: *“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:*

a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës”.

Neni 13, pika 1: *“Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim”.*

Kriteri: Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35, pika 1 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1, pika 2 germa “a”, neni 13, pika 1.

Efekti/Ndikimi: Mos plotësimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit për planifikimin e nevojës për prokurim, nuk paraqet qartë shkaqet e planifikimit.

Shkaku: Mungesa e analizës/raportit teknik, mbi vlerësimin e gjendjes aktuale të sistemeve IT si pjesë përbërëse e dosjes së prokurimit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: -Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese që në të ardhmen analiza teknike dhe financiare për planifikimin e nevojave për prokurim të jetë pjesë përbërëse e dosjeve të prokurimit.

Afati i zbatimit Menjëherë dhe rast pas rasti

Komisioni i llogaritjes së fondit limit për procedurën “auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve e sigurisë së sistemeve IT”, pas studimit të tregut ka llogaritur vlerën 3,333,300 lekë e cila është publikuar në ndryshimet e regjistrit të parashikimeve për prokurimin publik.

Llogaritja e fondit limit- Njësia e Prokurimit/Grupi për llogaritjen e fondit limit i është referuar studimit paraprak të tregut në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 35 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i ndryshuar neni 12,13 dhe 76, duke marrë oferta nga 3 operatorë ekonomikë dhe llogaritur mesataren e tyre. (Procesverbali Nr.411/3, datë 08.05.2023).

Nxjerrja e urdhër prokurimit- Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 77, VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar është nxjerrë Urdhër Prokurimi Nr. 87, datë 23.09.2022 në të cilin është ngarkuar Njësia e Prokurimit për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim- Njësia e prokurimit ka hartuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim bazuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar (Procesverbali Nr.411/6, datë 15.05.2023).

Vlerësimi i Ofertave-Në hapjen publike të ofertave në sistemin elektronik të prokurimit (SEP) rezulton të kenë shpallur interes dhe paraqitur ofertë 2 OE:

-OE “F” SHPK, me vlerë 2,850,000 lekë pa TVSH.

-OE “I” SHPK, me vlerë 3,166,000 lekë pa TVSH.

Nga KVO është klasifikuar oferta e OE “I” SHPK me vlerë më të lartë duke skualifikuar ofertën me vlerë më të ulët për mospërmbushje të kriterëve.

Titulli i gjetjes: Mos pasqyrim i plotë në procesverbalin e KVO i shqyrtimit të certifikatës për B. L. në likun e paraqitur nga OE.

Situata: Nga auditimi në SPE dhe dosje fizike të OE të skualifikuar me vlerën më të ulët të ofertës “F” SHPK rezulton:

-certifikata e lëshuar për B. L. nga “C” rezulton të jetë active ndërkohë që KVO e ka skualifikuar operatorin pasi, në SPE dokumenti i paraqitur nga OE rezulton pa linkun përkatës të verifikimit dhe pa kodin e sigurisë për të cilin KVO i ka kërkuar OE me e-mail të sjellë linkun përkatës si dhe kopje të certifikatës.

KVO pas dërgimit nga ana e operatorit të linkut nuk arriti të gjejë këtë certifikatë dhe OE nuk ka sjellë kopje të saj sipas kërkesës së KVO.Në procesverbalin e mbajtur nga KVO mbi shqyrtimin e certifikatës së sipërcituar, nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të qartë mënyra e kërimit dhe verifikimit në linkun përkatës, si dhe nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i gjeneruar pas verifikimit të linkut, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i” ku përcaktohet se:

“2. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. (Procesverbali 411/16, datë 05.06.2023).

Kriteri: -VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i”.

Efekti/Ndikimi: Procesverbali i KVO nuk pasqyron në mënyrë të plotë shqyrtimin e dokumentacionit/certifikatës të OE.

Shkaku: Mos shqyrtimi nga KVO i dokumentacionit të operatorit ekonomik.

Rëndësia: E ulët

Rekomandimi: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese, që në të ardhmen procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, të reflektohet në tërësi dhe në çdo detaj të tij në procesverbalin e mbajtur prej saj, me qëllim që procesi i vlerësimit të jetë transparent.

Afati i zbatimit Në vijimësi

Ndaj vendimit të klasifikimit të bërë nga KVO, OE "F" SHPK në rrugë elektronike ka bërë ankimin në KPP. Nga AK i është dërguar njoftim operatorit në lidhje me ankesën ku ka parashtruar kushtet e paraqitjes së saj si dhe detyrimin për të bërë pagesën pranë KPP duke i lënë afat 2 ditë nga njoftimi. Operatori në rrugë elektronike me datë 22.06.2023 ka kthyer përgjigje mbi ankimin duke u shprehur se heq dorë prej tij dhe për këtë arsye nuk ka bërë dhe pagesën. Për rrjedhojë AK njofton operatorin me shkresën Nr. 411/21, datë 30.06.2023 mbi shkaqet e mos shqyrtimit të ankesës. Gjithashtu dhe KPP me Vendimin Nr.567/2023 ka vendosur mos pranimin e ankesës për shkaqet e sipërcituara nga AK.

Lidhja dhe zbatimi i kontratës-Me OE fitues "I" SHPK është lidhur kontrata Nr.411/27, datë 14.07.2023 me vlerë 3,166,000 lekë pa TVSH/3,799,200 lekë me TVSH.

Me Urdhërin Nr.411/28, datë 14.07.2023 është caktuar personi për ecurinë e zbatimit të kontratës i cili me procesverbalin Nr.411/44 datë 19.10.2023 ka evidentuar realizimin me sukses të kontratës. Në kushtet e vecanta të kontratës neni 5.1 është kërkuar nga kontraktori/OE "I" SHPK të paraqesë: raportin fillestar, raportin përfundimtar (*ku përfshihet raporti i gjendjes aktuale, raporti i gjetjeve të testimit të sigurisë dhe strategjia e digjitalizimit*).

Me shkresat Nr.1022, datë 30.10.2023 dhe Nr. 1022/1, datë 07.11.2023 janë kërkuar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) 2(dy) specialistë të fushës për të qënë pjesë e komisionit të ecurisë për zbatimin e kontratës, meqënëse prokurimi i kryer për auditimin e funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemit IT është i pari në llojin e tij që kryen ky institucion, por nga AKCESK nuk është kthyer përgjigje. Gjithashtu me shkresën Nr. 1140, datë 22.11.2023 është kërkuar nga AKSHI të vihen në dispozicion 2 specialistë të fushës. Në përgjigje, AKSH-i me shkresën Nr.1140/1, (*prot. GJK*) datë 07.12.2023 ka cituar se kërkesa është jashtë fushës së përgjegjësië që ka AKSHI-i.

Personi për ecurinë e zbatimit të kontratës (*K.S*) me e-mail datë 16.08.2023 ka kërkuar nga AKSH-i udhëzime për realizimin e kontratës në lidhje me penetration test dhe me e-mail 17.08.2023 AKSHI ka dhënë rekomandimet e tij ku sugjeron që: *penetration test të mos kryhet nga të njëjtët persona të kompanisë kontraktuese, kompania duhet të dorëzojë një plan të mirëpërcaktuar për ndërhyrjen. Plani duhet të bëhet share/ndahet dhe me ekspertët e Drejtorisë së Monitorimit dhe Mbrojtjes Kibernetike për sistemet dhe Infrastrukturat e Gov-në mungesë të specialistëve të mirëfilltë të sigurisë kibernetike të GJ*".

Personi për ecurinë e zbatimit të kontratës, me e-mail datë 08.09.2023 i ka dërguar OE "I." miratimin për kryerjen e testeve pas komunikimeve me Drejtorinë e Monitorimit dhe Mbrojtjes Kibernetike pranë AKSH-it.

Me Urdhërin Nr.48, datë 14.07.2023 është caktuar Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit i cili ka mbajtur procesverbalin Nr.411/41, datë 13.10.2023. (*E. B., K. S. dhe O. T.*). OE është likujduar në zbatim të kontratës me Urdhër Shpenzimin Nr.342. datë 14.12.2023 në vlerën 3,799,200 me TVSH.

Konkluzion: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me object "Rikonstrukcion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese" viti 2022 dhe "Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT" viti 2023 rezultoi:

☞ Në kërkesën Nr.411, datë 26.04.2023, (*Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT*) për planifikimin e nevojës për prokurim nuk parashtrohet qartë nga kush është bërë evidentimi i gjendjes aktuale të sistemeve IT, si dhe nuk është bashkangjitur kërkesës analiza/raporti teknik i vlerësimit gjendjes aktuale të sistemeve

IT, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1, pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1;

☞ në hartimin e dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta, pika 2.3.7 (*Rikonstrukcion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese*) vendosja e kriterit nuk është e qartë në raport me objektin e kontratës, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar neni 35, pika 2 dhe 3;

☞ Në vlerësimin e ofertave nga KVO, në tenderin me object:

“Rikonstrukcion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese” ka mungesë informacioni në plotësimin nga 2 OE e BOE i shtojcës 8, pjesa 1. A, jo në përputhje me DT, Shtojca 8, pjesa 1, pika A;

“Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT”, nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të qartë në procesverbalin e KVO-së, mënyra e kërkimit dhe verifikimit në linkun përkatës si dhe nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i gjeneruar pas verifikimit të linkut, për certifikatën e lëshuar nga “C” paraqitur nga OE, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 82, pika 2 dhe germa “i”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.154/9, datë 20.03.2024 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Kryetare e Gjykatës Kushtetuese, ku ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: “...me autorizimin nr.954 prot., datë 12.10.2023... kishte nisur auditimi i brendshëm për procedurën...“Auditimit dhe vlerësimin të funksionaliteteve....IT”.Nga auditimi i brendshëm u konkluduan këto gjetje:

1.”Në lidhje me gjetjen nr.7... në raportin tuaj është dhënë një rekomandim që nuk mund të zbatohet pasi, nuk lejohet që për një procedurë të përfunduar të shtosh një dokumentacion i cili në fakt duhet të ishte indicie për parregullsi të procesit”.

2.”Skualifikimi i një operatori ekonomik për arsye të mos disponimit të certifikatës...është trajtuar në raportin tuaj si mos pasqyrim i plotë i shqyrtimit të certifikatësGjithashtu është trajtuar si një gjetje me rëndësi të ulët...”.

3.”Nuk kuptohet se nga kush janë përgatitur termat e referencës për këtë prokurim”.

4.”...Po ashtu sipas projekt raportit të KLSH rezulton se është mbajtur procesverbali i ecurisë së zbatimit të kontratës...nga z.K.S. si person përgjegjës për ecurinë e zbatimit të kontratës...Ndërkohë që përgjegjës për mbikëqyrjen e saj ishte Komisioni i ngritur me urdhërin e dubluar... , nuk gjendet në dosje asnjë raport mbikëqyrës dhe kontrollues i produktit final që erdhi nga kontrata e shërbimit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Në lidhje me **komentin 1**, sqarojmë se: Në periudhën objekt auditimi, njësia e auditimit të brendshëm i këtij subjekti ishte në fazë të përgatitjes së Projektraportit të Auditimit trajtuar dhe më lart. Auditimi i KLSH ishte i pavarur në kushtet kur nuk ishte miratuar Raporti Final i Auditimit, në mënyrë që të bëhej vlerësimi i auditimit mbi gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga AB i Gjykatës Kushtetuese.Gjithashtu auditimi u krye mbi bazën e dosjes së auditimit të vënë në dispozicion nga Zyra e Arkivit me datë 09.01.2024 dhe dorëzuar me datë 29.01.2024 nga grupi i auditimit.Nga shqyrtimi i Raportit Final të auditimit bashkëngjitur observacioneve dhe komenteve të bëra nga subjekti, pas shqyrtimit të tyre, si dhe nga sqarimet e dhëna në takimin e mirëkuptimit organizuar në KLSH datë 12.04.2024, me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese, rezultoi se: Grupi i auditimit ka konstatuar paqartësi në përmbajtjen e kërkesës Nr.411, datë 26.04.2023, për planifikimin e nevojës për prokurim dhe ka evidentuar mungesën bashkëlidhur kësaj kërkesë, të analizës teknike mbi vlerësimin e gjendjes aktuale të sistemeve IT, (nga kush është bërë vlerësimi etj.) jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1 sipas së cilës, AK duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te

zbatimi i kontratës. Nisur nga pretendimi i subjektit, se ka një korrespondencë me Kuvendin në lidhje me planifikimin e buxhetit për këtë prokurim, është dhënë rekomandimi në Projektraport që *“nga Gjykata Kushtetuese të merren masa për plotësimin e dosjes së prokurimit apo dhe administrimin e shkresave që lidhen me këtë procedurë prokurimi”*, për aq kohë nëse kjo korrespondencë është e protokolluar. Në këto kushte, komenti i subjektit **merret** në konsideratë dhe u trajtua në materialin e auditimit duke u bërë ndryshimet në rekomandimin e dhënë: *“Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese që në të ardhmen analiza teknike dhe financiare për planifikimin e nevojave për prokurim të jetë pjesë përbërëse e dosjeve të prokurimit”*.

Nga GJK në takimin e organizuar në KLSH, datë 12.04.2024, nga subjekti u paraqit shkresa me objekt *“Kërkesë shtesë për shpenzime operative dhe investime në buxhetin e vitit 2023”*, pa nr. prot., dhe pa datë, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë/Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nga Sekretari i Përgjithshëm. Në kërkesë, pika 2.1. *“Mbrotjtja kibernetike”*, shprehet shqetësimi mbi sulmet kibernetike të krijuara në vendin tonë si dhe situata aktuale mbi gjendjen e serverave në përdorim, duke u shprehur se *“...Për të gjitha arsyet që dhamë më lart është e domosdoshme upgrade i serverave, fireëall-it dhe backup-it, blerja e një serveri të ri i cili përmban të gjitha elementet e lartpërmëndura dhe i cili përfaqëson do kishte kosto rreth 4,000,000 lekë”*. Gjithashtu në Vendimin Nr.2, datë 24.01.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve janë miratuar në parim (parashikimi) shpenzimet buxhetore për vitin 2023, ku në Raportin e paraqitur për realizimin e buxhetit të vitit 2022 dhe përcaktimin e drejttimeve kryesore të shpenzimeve buxhetore për vitin 2023, në zërin *“investime kapitale”* miratuar në vlerën 8,000,000, lekë jepet sqarimi se *“fondi fillestar i alokuar për vitin 2023 ishte 4,000,000 lekë, ndërkohë që nga komisioni dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë u pranua dhe u akordua një rritje e zërit me +4,000,000 lekë duke çuar fondin e investimeve në vlerën 8,000,000 lekë. Kjo rritje prej 4,000,000, lekë është alokuar për pajisje kompjuterike dhe konkretisht për blerjen e një serveri të ri për GJK...”*.

Nga KLSH është evidentuar fakti që nga Komisioni për përgatitjen e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike në relacionin Nr.33/5, datë 09.05.2023 drejtuar SP, janë argumentuar ndryshimet e kërkuara në regjistrin e parashikimeve ku citohet se *“...nisur nga raporti i komisionit të K.LL.F.L.S.T. për kërkesën e datës 26.04.2023 ..elementi i zërit në Regjistrin e Parashikimeve me objekt: “Blerje PC, pritera, server-fireëall e pajisje të tjera informatizimi” i sipërpërmëndur do të modifikohet në elementin e zërit në Regjistrin e Parashikimeve me objekt “Auditim dhe vlerësimin e funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT” me fond limit 3,333,300 lekë”*. Pra siç shihet në regjistrin e parashikimeve është ndryshuar objekti i tenderimit, ndryshim i cili nuk del qartë, pasi nuk argumentohet në lidhje logjike dhe koherente me shkresat e sipërcituara për ndryshimin e bërë. Bazuar në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 3, pika 4, përcaktohet në mënyrë eksplicite se *“APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa. Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë”*, ndërkohë që nga APP nuk ka patur një kontestim të tillë për ndryshimin e bërë. Gjithashtu dhe në termat e referencës të përgatitur nga AK nuk del kërkesa për blerje serveri.

Në këto kushte, komenti i subjektit **merret pjesërisht** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Në lidhje me **komentin 2**, sqarojmë se: Konstatimi i KLSH ka të bëjë me parregullësitë e konstatuara përsa i takon trajtimin në procesverbalin e mbajtur nga KVO në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe konkretisht të certifikatës B.L. të paraqitur nga OE “F” SHPK në likun e sjellë prej tij, ç’ka do të thotë që KVO duhet të përshkuajë me hollësi mënyrën e procedimit në sistemin e prokurimit elektronik, gjenerimin e të dhënëve për këtë tip certifikate. Në lidhje me mosparaqitjen e kopjes së certifikatës nga OE, KVO e ka skualifikuar atë pasi i

ka bërë më parë kërkesë për paraqitje dhe sqarim. Komenti i subjektit **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Në lidhje me **komentin 3**, sqarojmë se: Me Urdhërin Nr.38, datë 27.04.2023 është ngritur grupi për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, grup i cili ka bërë studimin e tregut dhe ka marrë oferta nga 3 OE duke llogaritur fondin limit sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 35 dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 12,13 dhe 76, trajtuar në procesverbalin Nr.411/3, datë 08.05.2023, mbajtur nga ky grup.Për rrjedhojë, komenti i subjektit **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Në lidhje me **komentin 4**, sqarojmë se:Në dokumentacionin e dosjes të administruar nga KLSH, rezulton se me Urdhërin Nr.48, datë 14.07.2023 është caktuar Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit i cili ka mbajtur procesverbalin Nr.411/41, datë 13.10.2023. (*E. B. K. S. dhe O. T.*), ndërsa me Urdhërin Nr.411/28, datë 14.07.2023 është caktuar personi për ecurinë e zbatimit të kontratës K.S.i cili me procesverbalin Nr.411/44 datë 19.10.2023 ka evidentuar përmbushjen e detyrime të kontratës Nr.411/27, datë 14.07.2023, që në kushtet e veçanta, neni 5.1 sanksionon detyrimin e kontraktuesit për shërbimin e kërkuar të paraqesë: raportin fillestar, raportin përfundimtar (*ku përfshihet raporti i gjendjes aktuale, raporti i gjetjeve të testimit të sigurisë dhe strategjia e digjitalizimit*) të cilat janë paraqitur nga OE në zbatim të kontratës dhe janë marrë në dorëzim nga AK, në asnjë rast nuk ka të përcaktuar detyrim për mbikqyrje të kryerjes së shërbimit. Komenti i subjektit **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga subjekti në takimin e datës 12.04.2024 në KLSH, mbi pjesëmarrjen e të njëjtin person K.S. si në përgatitjen e termave të referencës, për ecurinë e zbatimit të kontratës ashtu dhe në marrjen në dorëzim të shërbimit sqarojmë se: Në zbatim të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 72,73 dhe 75 nuk rezulton që K.S. të jetë njëkohësisht dhe anëtar i Njësisë së Prokurimit/hartimit të termave të referencës dhe KVO. Gjithashtu dhe Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik nuk shprehet për këtë fakt. Komenti i subjektit **nuk merret** në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022, rezulton se në llogarinë 327 “Objekte Inventari”, shuma prej 832,850 lekë është e trashëguar nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përfaqëson vlerën e “Aktivet afatshkurtra jo financiare (*Inventarët*) dhe mos ndryshimi i saj ka ardhur si rezultat i mos reflektimit në kontabilitet të daljeve të materialeve të imta, të cilat janë materiale konsumi dhe në momentin që ky mall del nga magazina, nga kontabiliteti duhet të bëhet veprimi kontabël duke kredituar llogaria 327 për këto mallra konsumi dhe debituar llogarinë 63 ”Ndryshimi i Gjendjes i Inventarit”, vlerë e cila ndikon në Pasqyrën e Performancës Financiare, në llogarinë 85 “Rezultati i Veprimtarisë të Institucionit”. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-34 të Raportit të Auditimit*)

1.1Rekomandimi: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese, për ngritjen e një grup pune me specialistë të fushës, për të kryer inventarizimin dhe saktësimin e vlerës prej 832,850 lekë në llogarinë 327 “Objekte Inventari”.

1.2 Rekomandimi:Të merren masa nga Drejtoria Ekonomike, të kryejë zbërthimin e

dokumentacionit financiar të trashëguar ndër vite në lidhje me këtë llogari, për nxjerrjen e të dhënave për aktivet afatshkurtra si pjesë përbërëse, duke i saktësuar dhe analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet si dhe në inventarin fizik.

Afati: Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022, Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 5,079,082 lekë si dhe në vitin 2021 me vlerë kontabël 1,432,020 lekë dhe në debi të saj janë kontabilizuar fatura për mallra dhe shërbime të pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore.

Nga auditimi rezulton detyrimet e prapambetura të cilat janë fatura për mallra dhe shërbime në fund të periudhës ushtrimore për vitin 2022 në shumën prej 5,079,028 lekë, janë keqklasifikuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, llogari e cila duhet të përfaqësojë debitorë (të trashëguar ndër vite). Shuma prej 5,079,028 lekë duhet të regjistrohej në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” e cila është një llogari që në PF të sektorit publik, paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit, për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit) me kundërpartit llogarinë nr.401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-34 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Drejtoria Ekonomike, për të kryer sistemimet e detyrimeve në kontabilitet në fund të periudhave ushtrimore duke i riklasifikuar ato në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” e cila është një llogari që në Pasqyrat Financiare të Sektorit Publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit, për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit) me kundërpartit llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”.

Afati:Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022, Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*”, rezulton se analitiku i kësaj llogarie përbëhet nga “projekte”, por për të cilat nuk ka të dhëna ku të specifikoheshin kërkesat që duhet të përmbajë një aktiv, mbi datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes etj.

Amortizimi i llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, ka vazhduar ndër vite për vlerat e mbetura në masën 15%, edhe pse nuk ka patur të dhëna se cilat janë këto projekte dhe nëse investimi përkatës është kryer ose jo.

Për këto aktive nuk ka të dhëna të mjaftueshme të specifikuara për secilin aktiv, gjithashtu ka mangësi pasi, mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve, viti i krijimit të tyre, jo në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 26 dhe pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-34 të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga ana e Strukturave Drejtuese në Gjykatën Kushtetuese, për ngritjen e një grup pune, për të kryer inventarizimin dhe saktësimin e vlerës së mbetur prej 242,340 lekë në llogarinë 202 “*Studime dhe Kërkime*”.

3.2 Rekomandimi: Të merren masa nga Gjykata Kushtetuese/Drejtoria Ekonomike, për të evidentuar dokumentacionin financiar të trashëguar ndër vite për studime dhe projekte të cilat janë bërë hyrje në Regjistrat e Aktiveve të Gjykatës Kushtetuese, duke saktësuar përshkrimet e tyre, vitin e hyrjes të projektit, investimet përkatëse nëse janë kryer sipas projekteve të caktuara, në mënyrë të tillë që vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare të jenë të vërtetuara me dokumentacion të plotë.

Afati:Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2023

